



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 263 Akti

**Nr. 237 Vendimi
Tiranë, më 12.2.2020**

V E N D I M:

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici	Kryesues
Firdes Shuli	Relatore
Brunilda Bekteshi	Anëtare

me sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datën 31.1.2020 dhe në datën 12.2.2020, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), kati i dytë, salla 0, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Adnand Xhelili**, me detyrë prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 179/b, A, Ç, D, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, të ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji relatimin e relatores së çështjes, znj. Firdes Shuli, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument të vënë në dispozicion nga organet kompetente ligjore, si dhe shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin Adnand Xhelili, bazuar në kriterin e kontrollit të pasurisë, mbështetur në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, dhe në përfundim, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Adnand Xhelili, si subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë që prej vitit 1995, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio*.
2. Referuar neneve 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).
3. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka zhvilluar shortin në datën 15.1.2019, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit, z. Adnand Xhelili, do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Olsi Komici, Brunilda Bekteshi dhe Firdes Shuli. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli.
4. Trupi gjykues, me vendimin nr. 1, datë 24.1.2019, vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Adnand Xhelili, si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjykues, komisioner Olsi Komici. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.
5. Në datën 21.2.2019 subjektit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti nuk deklaroi konflikt interesi me ndonjë prej anëtarëve të trupit gjykues.
6. Trupi gjykues, me vendimin nr. 2, datë 12.12.2019, vendosi përfundimin e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit, z. Adnand Xhelili vetëm për kriterin e pasurisë dhe njohjen e subjektit me rezultatet e këtij hetimi, të cilat iu dërguan në rrugë elektronike në datën 19.12.2019.
7. Në datën 25.12.2019 subjekti informoi Komisionin në rrugë elektronike se gjendja e tij shëndetësore e bënte objektivisht të pamundur paraqitjen e provave dhe parashtrimeve brenda afatit të caktuar, vërtetuar me raportin mjeko-ligjor për paaftësi të përkohshme për periudhën 25.12.2019 – 8.1.2020, lëshuar në datën 24.12.2019, duke kërkuar t’i mundësohet një kohë e mjaftueshme për përmbushjen e detyrimeve të tij.
8. Trupi gjykues, me vendimin nr. 3, datë 6.1.2020, vendosi të shtyjë afatin e paraqitjes së parashtrimeve mbi rezultatet e hetimit deri në datën 15.1.2020, shtyrje e cila iu bë me dije subjektit po në datën 6.1.2020.
9. Në datën 9.1.2020 subjekti informoi në rrugë elektronike se gjendja e tij shëndetësore e bënte të pamundur kthimin e përgjigjeve brenda afatit të ri të përcaktuar, vërtetuar me raportin për paaftësi të përkohshme në punë, lëshuar në datën 7.1.2020, për periudhën 8.1.2010 – 7.2.2020.
10. Trupi gjykues, me vendimin nr. 4, datë 14.1.2020, vendosi të caktojë si afat për paraqitjen e parashtrimeve dhe provave datën 27.1.2020 dhe zhvillimin e seancës dëgjimore datën 31.1.2020.

11. Në datën 27.1.2020, subjekti vuri në dispozicion në rrugë elektronike parashtrimet e tij mbi rezultatet e hetimit dhe dokumenta shoqëruese.

12. Në datën 31.1.2020, u zhvillua seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, Adnand Xhelili, sipas nenit 55 të ligjit 84/2016.

II. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI

II.1 VLERËSIMI I PASURISË

II.1.1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Nga aktet e ILDKPKI-së rezulton se subjekti ka dorëzuar rregullisht deklaratat e interesave private nga viti 2004 (për vitin 2003) deri në vitin 2017 (për vitin 2016). Në datën 24.1.2017, sipas ligjit nr. 84/2016, subjekti ka dorëzuar “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, Vetting” në ILDKPKI, në përputhje me nenin 32/1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

ILDKPKI-ja ka kryer kontroll të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të, sipas neneve 30 - 33, të ligjit nr. 84/2016 dhe me aktin nr. *** prot., datë 17.9.2018, ka konkluduar se:

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për burimin e krijimit të pasurisë;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

II.1.2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Megjithëse sipas kreut IV, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror, referuar vendimit nr. 2/2017[1], të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizoi një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi të kriterit pasuror për subjektin e rivlerësimit, z. Adnand Xhelili, i cili nuk është bazuar dhe as është detyruar nga përfundimet e paraqitura nga ILDKPKI-ja.

Komisioni, në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese, ka kryer një proces të plotë hetimi administrativ për pasurinë e subjektit Adnand Xhelili dhe personave të lidhur me të, sipas dispozitave ligjore të kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në: (i) deklaratimet e subjektit në ILDKPKI; (ii) provat shkresore të administruara nga ky institucion dhe raporti i dorëzuar në Komision; (iii) çdo dokument ligjor që përbën mjet prove ligjore të kërkuar nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit, sipas nenit 49, të ligjit nr. 84/2016; si dhe (iv) komunikimet me subjektin, sipas nenit 46, të ligjit nr. 84/2016 dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative.

Hetimi administrativ në lidhje me rivlerësimin e pasurisë, konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklaratimeve të rreme; si dhe (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim verifikimin

e deklarimeve të pamjaftueshme, sipas parashikimit të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

Hetimi administrativ sipas neneve 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84 /2016, është kryer në lidhje me:

Pasuri të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting”, si vijojnë:

1. Apartament banimi me sip. 117.13 m², i ndodhur në Rr. “****”, ***, Tiranë, i blerë nga Enti Kombëtar i Banesave (në vijim EKB), në vitet 1999 - 2005, në vlerën 1.159.456 lekë.

Burimi i krijimit: kursime.

Pjesa takuese: 100 %.

ILDKPKI-ja, për këtë pasuri, ka konstatuar se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e dorëzuar dhe me përgjigjen e ardhur nga ZQRPP-ja.

Faktet dhe provat e administruara gjatë hetimit administrativ:

1.1 ZVRPP-ja Tiranë¹ konfirmoi të regjistruar në emër të shtetasve Adnand dhe M. Xh. pasurinë apartament me sip. 117.13 m², me nr. ***,² me adresë: Rr. “****”, ***, p. ***, shk. ***, ap. ***, i përbërë nga tri dhoma, kuzhinë dhe ambiente ndihmëse.

1.2 OSHEE-ja³ konfirmoi se z. Adnand Xhelili është abonent në instancën e Tiranës, ***, me datë hapjeje 15.9.1998.

1.3 Në lidhje me mënyrën e krijimit të pasurisë dhe fitimit të pronësisë, nga aktet e vëna në dispozicion nga ILDKPKI-ja⁴, si dhe dokumentet e vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit⁵, në rend kronologjik janë kryer procedurat ligjore, si vijojnë:

1.3.1 Me vendim nr. ***, datë 2.9.1993, të kryetarit të Bashkisë Tiranë, shtetasit Sh. Xh. (babai i subjektit), gruas dhe tre fëmijëve të tij, i është miratuar leja e banimit në qytetin e Tiranës. Në certifikatën familjare, që vërteton gjendjen familjare në datën 1.12.1992⁶, subjekti është pjesë përbërëse e saj.

1.3.2 Me autorizimin nr. *** prot., datë 24.1.1996, lëshuar nga Bashkia Tiranë, shtetasit Adnand Xhelili i është dhënë apartament me tri dhoma e kuzhinë në bllokun “****”, k. ***, ap. ***, sipas shkresës nr. *** prot., datë 1.11.1995, të EKB-së, bazuar në shkresën nr. ***, datë 18.12.1995, të Këshillit të Ministrave.

1.3.3 EKB-ja, pasi iu kërkua informacion nga Komisioni, informoi se z. Adnand Xhelili nuk ka lidhur kontratë për apartamentin e ndodhur në bllokun “****”⁷. Sipas EKB, për këtë apartament është lidhur kontratë privatizimi me shtetasin F. B. në datën 2.9.1997, bazuar në autorizimin datë 15.10.1996, të lëshuar nga Bashkia Tiranë.

1.3.4 Me kërkesën (pa datë) drejtuar kryetarit të Bashkisë Tiranë, subjekti, si banor i qytetit të Tiranës, që me statusin e të pastrehut kishte përfutur një apartament banimi të ndodhur në bllokun “****”, ka kërkuar që këtë apartament ta ndërrojë me një apartament me të njëjtën sipërfaqe në pallatin e ndodhur në “****”, pranë ***, për arsye se ky pallat ndodhet pranë bllokut të pallateve të organeve të drejtësisë, gjë që e bën të jetë më i kontrolluar.

¹ Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. ***prot., datë 7.3.2019, nga ZVRPP-ja Tiranë, në dosjen e Komisionit.

² Shihni vërtetimin nga dokumenti hipotekor me datë 4.4.2005, ne aneksin 4/2 të ILDKPKI-së.

³ Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 4.3.2019, dhe shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 15.3.2019, nga OSHEE-ja, në dosjen e Komisionit.

⁴ Shihni aktet në aneksin 4/2, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵ Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit.

⁶ Shihni certifikatën familjare për gjendjen familjare të datës 1.12.1992, bashkëngjitur shkresës kthim-përgjigje nr. ***, prot., datë 17.10.2019, nga EKB-ja në dosjen e Komisionit.

⁷ Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 12.11.2019, nga EKB-ja në dosjen e Komisionit.

1.3.5 Me autorizimin provizor nr. *** prot., datë 19.6.1996, lëshuar nga seksioni i strehimit të Bashkisë Tiranë, shtetasit Adnand Xhelili i është aprovuar kërkesa për ndërrimin e pasurive dhe i janë dhënë 3 dhoma dhe 1 kuzhinë në adresën: ***, k. ***, ap. **. Sipas informacionit të EKB-së, nuk është lidhur një kontratë këmbimi i dy apartamenteve, fakt që tregon se subjekti nuk ka kryer asnjëherë procedura për përfitimin e apartamentit në bllokun “***” dhe nuk ka banuar asnjëherë në këtë apartament, ashtu sikurse rezultoi e vërtetuar edhe gjatë hetimit administrativ.

1.3.6 Me kontratën e shitjes me kusht nr. ***, datë 20.5.1999⁸, shtetasit Adnand Xhelili dhe M.Xh. kanë blerë nga EKB-ja apartamentin me sip. ndërtimi 117.13 m², në adresën: ***, k. ***, ap. **.

1.3.7 Me kontratën e shitjes përfundimtare nr. ***, datë 30.3.2005, subjekti dhe bashkëshortja kanë fituar pronësinë mbi apartamentin në adresën: ***, k. ***, ap. **.

1.3.8 Sipas vërtetimit, datë 4.4.2005, të lëshuar nga ZVRPP-ja Tiranë, ky apartament është regjistruar si pasuria nr. ***, në pronësi të subjektit dhe të bashkëshortes.

1.4 Në lidhje me likuidimin e çmimit të shitjes së pasurisë:

1.4.1 Kontrata e shitjes me kusht nr. ***, datë 20.5.1999, parashikon si vlerë të shitjes së apartamentit shumën prej 1.618.081 lekësh, nga e cila është zbritur shuma prej 123.175 lekësh, që përfaqëson vlerën e punimeve të kryera, meqenëse blerësi kishte statusin e të pastrehut. Sipas kontratës, nga vlera e mbetur prej 1.494.806 lekësh (1.618.081 lekë - 123.175 lekë), blerësi ka paguar: (i) shumën prej 40.000 lekësh, vërtetuar me dokumentin nr. ***, datë 25.10.1996; (ii) shumën prej 40.000 lekësh, vërtetuar me dokumentin nr. ***, datë 27.10.1997 (e cila nuk është marrë në konsideratë në llogaritjet e EKB-së në kontratën përfundimtare të shitjes, trajtuar në vijim); si dhe (iii) shumën prej 62.675 lekësh, vërtetuar me dokumentin nr. ***, datë 16.10.1997. Shuma e mbetur për t’u shlyer është 1.352.131 lekë (1.494.806 - 80.000 - 62.675), e cila sipas kontratës së shitjes me kusht është parashikuar që të shlyhet në 300 këste të barabarta mujore në shumën 4.507,1 lekë.

1.4.2 Kontrata e shitjes përfundimtare nr. ***, datë 30.3.2005, e cila i referohet kontratës së shitjes me kusht nr. ***, datë 20.5.1999, në lidhje me pagimin e çmimit të shitjes, parashikon se: (i) në datën 27.10.1997 është paguar shuma prej 40.000 lekësh, që përfaqëson pagesën fillestare; (ii) në datën 16.10.1997 është paguar shuma prej 62.675 lekësh, që përfaqëson vlerën e shpenzimeve operacionale; si dhe (iii) deri në mars të vitit 2005 janë paguar këstet në bazë të kontratës së shitjes me kusht, në shumën 326.500 lekë (4.507,1 lekë/muaj x 72 muaj, për periudhën 20.5.1999 – 30.3.2005).

Në kontratën e shitjes përfundimtare është sqaruar se: “...palës blerëse, e cila ka statusin e të përndjekurit politik, sipas shkresës nr. ***, datë 3.6.2004, i takon banesa falas. Por, duke qenë se sipas certifikatës familjare të paraqitur pranë palës shitëse, ka rezultuar një sipërfaqe tepër prej 37.13 m², pala blerëse ka paguar vetëm vlerën e kësaj sipërfaqeje në shumën 579.778 lekë. Pasi tre pagesa janë kryer (me përshkrimin si më sipër), palës blerëse i ka mbetur për të paguar shuma prej 150.503 lekësh, e cila është likuiduar totalisht cash nga pala blerëse, sipas mandatarkëtimit nr. 871, datë 30.3.2005”.

Duke qenë se mandatarkëtimi nr. ***, datë 30.3.2005 dhe shkresa nr. ***, datë 3.6.2004 nuk disponoheshin nga Komisioni, subjektit iu kërkua të vërë në dispozicion këto dokumente, si dhe të japë sqarime mbi periudhat e likuidimit të çmimit të blerjes, shoqëruar me dokumenta

⁸ Shihni aktin bashkëlidhur shkresën kthim-përgjigje nga noteri D. H., protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot, datë 17.10.2019, në dosjen e Komisionit, si dhe bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2 të dërguar nga subjekti, në dosjen e Komisionit.

vërtetuese. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka cituar të njëjtën mënyrë pagese të parashikuar në kontratën e shitjes me kusht të vitit 1999 dhe në kontratën e shitjes përfundimtare të vitit 2005, si dhe ka vënë në dispozicion : (1) shkresën nr. *** prot., datë 3.6.2004, të Institutit të Integritetit të Përndjekurve Politikë, sipas të cilës ky institucion i ka kërkuar EKB-së privatizimin e banesës falas për shtetasin Adnan Sh. Xhelili, me statusin e të përndjekurit politik, grupi C, sipas vendimit nr. ***, datë 1.6.1995; si dhe (2) kontratat përkatëse dhe dokumentet që vërtetojnë procedurat e privatizimit të apartamentit.

Subjekti, në përgjigjet e tij, nuk e ka vënë në dispozicion mandatarkëtimin nr. ***, datë 30.3.2005, por këtë dokument shkresor e ka depozituar së bashku me parashtrimet e datës 27.1.2020. Sipas këtij mandatarkëtimi vërtetohet pagimi i shumës së mbetur pa u paguar prej 150.503 lekësh, pasqyruar në kontratën përfundimtare të shitjes.

Në përfundim të hetimit administrativ, nga të gjithë dokumentet shkresore të administruara si më sipër, rezultoi se z. Adnan Xhelili i është dhënë e drejta e privatizimit të banesës si i përndjekur politik me statusin e të pastrehut, në zbatim të VKM-së nr. 291, datë 21. 6.1994, “Për kriteret e vlerësimit të apartamenteve që ndërtohen me fonde shtetërore”, i ndryshuar, dhe për shkak të përfitimeve, vlera reale e paguar prej tij është shuma prej 579.778 lekësh (40.000 lekë + 62.675 lekë + 326.500 lekë + 150.503 lekë), e cila është konsideruar si shpenzim për blerjen e pasurisë gjatë analizës financiare.

1.5 Nga deklaratimet periodike vjetore të subjektit ka rezultuar se kjo pasuri është deklaruar, si vijon:

- Në deklarin për vitin 2003, është deklaruar: *shtëpi banimi, me sip. 100 m², vlera 1.400.000 lekë, me adresë: Rr. “***”, ***. Burimi: kredi nga Enti Kombëtar i Banesave.* Në këtë deklarin, në pjesën “detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” deklarohet *marrje kredie për strehim nga Enti Kombëtar i Banesave, në shumën 1.400.000 lekë.*

- Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005 kjo pasuri, e cila është blerë me kontratën e shitjes, datë 30.3.2005, nuk është deklaruar.

- Në deklaratën “Vetting” pasuria është deklaruar në vlerën 1.159.456 lekë, me burim i krijimit: kursime, dhe pjesë takuese: 100%. Ndërkohë, nga hetimi administrativ u konstatua se për blerjen e pasurisë subjekti ka paguar realisht vlerën prej 579.778 lekësh.

Siç vërehet, ka pasur pasaktësi dhe mospërputhje në deklarinet e vlerës së pasurisë, për të cilat subjektit i është kërkuar të japë sqarime gjatë procesit të rivlerësimit, por, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, nuk ka dhënë asnjë përgjigje.

Në përfundim të hetimit administrativ, me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu rikërkuan sqarime lidhur me konstatimet, si vijojnë:

Së pari: ka mospërputhje në lidhje me burimin e pasurisë, pasi në vitin 2003 si burim krijimi është deklaruar kredia e marrë nga EKB-ja, ndërsa në deklaratën “Vetting” si burim janë deklaruar kursimet. Në lidhje me këtë konstatim subjekti deklaroi se *shlyerja e shumës pranë EKB-së është kryer mbi bazën e të ardhurave dhe kursimeve familjare.*

Së dyti: ka mospërputhje në lidhje në deklarinet e vlerës së pasurisë, pasi në vitin 2003 pasuria është deklaruar me vlerë 1.400.000 lekë, ndërsa në deklaratën “Vetting” është deklaruar në vlerën 1.159.456 lekë. Në lidhje me këtë konstatim, subjekti deklaroi se *vlera e kësaj pasurie është 1.400.000 lekë, pra, aq sa është deklaruar në deklaratën për vitin 2003, kurse në deklaratën “Vetting” është bërë një gabim prej tij lidhur me këtë vlerë...*, si dhe ka vënë në dispozicion: (1) shkresën nr. *** prot., datë 30.12.2019, të EKB-së; dhe (2) katër mandatpagesa me të cilat është shlyer vlera e apartamentit të blerë nga EKB-ja.

Së treti: pasuria nuk është deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005. Në lidhje me këtë konstatim subjekti deklaroi se *kjo pasuri është deklaruar në deklaratën e vitit 2003, ndërkohë që kërkesa e formularit të ILDKPKI-së kërkon në vazhdimësi ndryshimet e pasurive dhe jo përsëritjen e deklaramit të tyre.*

Vlerësimi i Komisionit

Së pari: në lidhje me mospërputhjen në deklaramin e burimit, Komisioni e vlerësoi të bazuar pretendimin e subjektit, pasi është e vërtetë që kursimet familjare të tij (deklaruar për deklaratën “Vetting”) kanë shërbyer si burim për pagimin kredisë së marrë nga EKB-ja (deklaruar në deklaratën periodike për vitin 2003). Si rrjedhim, mospërputhjet në deklarime nuk kanë sjellë asnjë pasojë.

Së dyti: në lidhje me pasaktësitë dhe shkaqet e mospërputhjeve në vlerat e pasurisë, subjekti nuk ka dhënë asnjë sqarim, por si vlerë reale të pasurisë deklaroi shumën prej 1.400.000 lekësh, të deklaruar në deklaratën periodike për vitin 2003, duke e konsideruar deklaramin për “Vetting” një lapsus. Në vlerësimin përfundimtar Komisioni çmoi se, pavarësisht faktit që në kontratat me EKB-në janë pasqyruar vlera të ndryshme të pasurisë, në varësi të përlllogaritjeve për shkak të përfitimit prej statusit të të pastrehut e të të përndjekurit politik, si dhe në varësi të periudhës së pagesave, në deklaratën “Vetting” subjekti duhet të deklaronte me saktësi dhe në mënyrë të detajuar vlerën e pasurisë dhe shumën e paguar prej tij për shkak të përfitimeve ligjore, mbështetur në dokumenta shkresore, të cilat do të kontrolloheshin nga ky institucion, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së⁹, gjë që nuk e ka bërë, duke e bërë deklaramin të pasaktë.

Së treti: në lidhje me mosdeklaramin e pasurisë në vitin 2005, kur pronësia është përfituar me kontratë përfundimtare shitjeje, Komisioni vlerëson që ky fakt, përbën pasaktësi në këtë deklaram. Por, në kushtet kur pasuria është deklaruar për vitin 2003, mosdeklarami i saj në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005 vlerësohet nga Komisioni se ka qenë për shkak të pakujdesisë në plotësimin e formularit, dhe jo me qëllim fshehjen e pasurisë.

1.6 Në lidhje me statusin e të pastrehut:

Ligji i zbatueshëm

a. Ligji nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, sipas të cilit, ndër kategoritë përfituese janë edhe ish të përndjekurit politikë (ose pjesëtarë të familjes), të cilët i përfitojnë banesat falas, por edhe shtetasit e pastrehë që për blerjen e banesës mund të marrin kredi nga EKB-ja. Në nenin 23 të këtij ligji parashikohet se: *“Nga ky ligj nuk përfitojnë edhe fshatarët që kanë marrë leje banimi në qytet pas datës 31.7.1991 dhe që kanë përfituar nga ligji ‘Për tokën’”.*

b. VKM-ja nr. 49, datë 29.1.1993, “Për përcaktimin e kriterëve për të pastrehët”, i cili parashikon që të gjitha kategoritë e të pastrehëve duhet të kenë lejen e banimit në qytet deri në datën 1.12.1992¹⁰.

Nga dosja e vënë në dispozicion nga EKB-ja¹¹ dhe nga dokumentet e dërguara nga subjekti në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka përfituar banesë nga privatizimi sipas dispozitave ligjore të sipërpërmendura, me statusin e të pastrehut, duke pasur ndërkohë edhe statusin e të përndjekurit politik, referuar fakteve si vijojnë:

⁹ Shihni vendimin nr. 9, datë 18.4.2019, të KPA-së që i përket subjektit të rivlerësimit, z. A. F.

¹⁰ Me këtë VKM, afati për pasjen e lejes së banimit në qytet është bërë deri në datën 1.12.1992.

¹¹ Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 17.10.2019 nga EKB-ja dhe dokumentacionin bashkëngjitur në dosjen e Komisionit.

- me vendimin nr. ***, datë 2.9.1993, të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, shtetasit Sh. Xh., gruas dhe tre fëmijëve, i është miratuar leja e banimit në qytetin e Tiranës;
- z. Adnand Xhelili ka qenë pjesë përbërëse e listës së të pastrehëve të grupit B të Bashkisë Tiranë, me datë 25.7.1995.
- me vendimin nr. ***, datë 1.6.1995, të Institutit të Integritit të të Përndjekurve Politikë, z. Sh. Xh. i është dhënë statusi i ish të përndjekurit politik (referuar shkresës nr. *** prot., datë 3.6.2004, të këtij institucioni).
- me shkresën nr. ***, datë 18.12.1995, të Këshillit të Ministrave, subjektit i është akorduar një banesë për privatizim në bllokun “****” (ndërruar me apartamentin në ***).
- me autorizimin nr. ***, datë 24.1.1996, subjektit i është lidhur kontrata e shitjes me kusht, nr. ***, datë 20.5.1999, pasuar nga kontrata e shitjes përfundimtare me nr. ***, datë 30.3.2005.

Bazuar në faktet si më sipër, në përfundim të hetimit administrativ, ka pasur paqartësi mbi përfitimin e statusit të të pastrehut nga subjektit të rivlerësimit, pasi, sipas parashikimeve ligjore, për të përfituar këtë status subjekti duhet të kishte pasur lejen e banimit në qytet deri në datën 1.12.1992, ndërkohë që atij dhe familjes së tij kjo leje i është miratuar në vitin 1993. Ndërkohë, u konstatua se subjekti ka përfituar nga ligji nr. 7501/1998, “Për tokën”. Në lidhje me këto paqartësi, subjektit i është kërkuar të japë sqarime dhe iu kalua barra e provës, sipas nenit 52, të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në parashtrimet e tij, subjekti ka dhënë sqarime koncize, si vijojnë:

- Në lidhje me përfitimin si i pastrehë, subjekti ka deklaruar se *nuk kishte përfituar nga apartamentet që i ishin vënë në dispozicion Prokurorisë së Përgjithshme për prokurorët e pastrehë në periudhën '94 - '95, periudhë në të cilën kishte jetuar në shtëpinë e vjehrrit të tij. Në shtator të vitit 1995, me Vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë u emërua Drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe në këto kushte iu drejtua me kërkesë për strehim Bashkisë Tiranë. Duke qenë se kjo gjë lidhej drejtpërdrejt edhe me funksionin dhe përmbushjen e detyrës, Kryeministri i asaj kohe, me shkresën nr. *** prot., datë 18.12.1995, i ka kërkuar Bashkisë Tiranë sistemimin e tij me një hapësirë të mjaftueshme për banim, bazuar në VKM-në nr. 530, datë 17.10.1994, pika 6.*

- Në lidhje me përfitimin nga ligji nr. 7501 “Për tokën” subjekti ka deklaruar se *familja e tij është familje ish-pronare tokash bujqësore, kullotash dhe trojesh, për shkak të të cilave edhe u viktimizua nga sistemi i kaluar. Më tej, sqaron se familja e tij ka përfituar tokë me një sipërfaqe shumë herë më të vogël nga ajo që iu ishte shtetëzuar dhe se tokën e kanë përfituar me aktin e marrjes së tokës në pronësi të datës 1.10.1995.*

Vlerësimi i Komisionit

Referuar ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore” ndër kategoritë përfituese si të pastrehë janë edhe ish të përndjekurit politikë (ose pjesëtarë të familjes), të cilët i përfitojnë banesat falas, por edhe shtetasit e pastrehë, të cilët për blerjen e banesës mund të marrin kredi nga EKB-ja.

Referuar VKM-së nr. 476, datë 10.10.1994, “Për procedurat e strehimit të ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”, i ndryshuar, pika 2, për strehimin e kategorisë së ish të dënuarve dhe të të përndjekurve politikë, zbatohen kriteret e përcaktuara në VKM-në nr. 49, datë 29.1.1993, “Për përcaktimin e kriterëve për të pastrehët”, sipas të cilit të gjitha kategoritë e të pastrehëve duhet të kenë lejen e banimit në qytet deri në datën 1.12.1992.

Subjekti është bërë qytetar i Tiranës në shtator të vitit 1993, pra pas nëntë muajve nga afati ligjor i parashikuar, si rrjedhim nuk përmbushej kriteri ligjor sipas të cilit, ai duhet te kishte lejen e banimit në qytet në datën 1.12.1992.

Me tej, Komisioni konstatoi se kanë qenë organet kompetente të cilat kanë vendosur përfitimin e apartamentit nga subjekti me statusin e të pastrehut dhe atë të të përndjekurit politik, duke kryer procedurat ligjore në raport me aktet nënligjore si vijojne:

- Sipas VKM nr. 49, datë 29.1.1993, “Për përcaktimin e kriterëve për të pastrehët”, kanë qenë komisionet e privatizimit në këshillat e rretheve, bashkive dhe komunave që, pasi verifikojnë kriteret ligjore, përcaktojnë këtë kategori qytetarësh dhe listën përkatëse.

-Sipas VKM nr. 530, datë 17.10.1994, “Për mënyrën e ndarjes së apartamenteve të ndërtuara nga Enti Kombëtar i banesave”, i ndryshuar, në pikën 6 të tij parashikon: “*Këshilli i Ministrave miraton gjithashtu listën e punonjësve në institucionet dhe ndërmarrjet buxhetore që do të trajtohen nga EKB-ja me shtesa anësore, shtesa kati etj., për plotësimin e nevojave të tyre për strehim, sipas normativave dhe kriterëve të strehimit në fuqi. Organet e pushtetit lokal dhe degët e Entit Kombëtar të Banesave në bazë të listave të miratuara nga KM-ja, kryejnë veprimet e nevojshme administrative dhe lidhin kontratat përkatëse sipas dispozitave në fuqi.*”

Në lidhje me faktin që në periudhën e përfitimit si i pastrehë, subjekti kishte përfituar tokë bujqësore sipas ligjit nr. 7501/1991, Komisioni vlerësoi pretendimin e subjektit, sipas të cilit AMTP-ja nr. ***, i është dhënë familjes së z. Sh. Xh. në datën 1.10.1995, ndërkohë që procedurat e privatizimit kanë nisur në dt. 25.7.1995. Gjithashtu, në vlerësimin përfundimtar të çështjes, Komisioni ka mbajtur në konsideratë faktin që subjekti ka përfituar tokë bujqësore, si anëtar i familjes bujqësore në fshatin Borsh Sarandë dhe jo si kryefamiljar.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, faktin e përfitimit të banesës nga privatizimi në mospërmbushje të kriterit ligjor i cili parashikon afatin për pasjen e lejes së banimit në qytet brenda datës 1.12.1992, Komisioni e çmoi në proporcion me rrethanat e tjera, sipas të cilave përfitimi i pasurisë është vërtetuar të jetë kryer në përmbushje të të gjitha kriterëve të tjera ligjore të parashikuara në ligj dhe VKM përkatëse, bazuar në dokumentacionin e lëshuar nga organet kompetente ligjore. Për këtë shkak, nuk e ka konsideruar këtë fakt, si shkak për penalizim të subjektit të rivlerësimit.

1.7 Në lidhje me burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë, të deklaruar kursime familjare:

Me qëllim verifikimin e burimit të krijimit të pasurisë apartament banimi në Rr. “****”, Tiranë, si shpenzim për blerjen e saj, në analizën financiare është konsideruar vlera reale prej 579.778 lekësh, e paguar nga subjekti, dhe jo ajo e deklaruar prej 1.159.456 lekë në deklaratën “Vetting”. Në analizën financiare për periudhën 1994 – 2003, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur si në tabelën më poshtë, duket se subjekti ka një diferencë të pajustificuar me të ardhura të ligjshme në shumën prej 429.913 lekësh, gjë që tregon se subjekti ka qenë në pamundësi financiare për të paguar brenda kësaj periudhe shumën prej 361.668 lekësh për blerjen e apartamentit¹².

	Përshkrimi	1994 – 2003
1	PASURI	1.079.778
	Apartament me sip. 100 m ² në Rr. “****”, sipas kontratës me sip. 117,13 m ²	579.778
	Likuiditete	500.000

¹² Shih pagesat e kryera parashikuar në Kontratën e shitjes përfundimtare nr. ***, datë 30.3.2005, trajtuar më sipër.

2	DETYRIME	218.110
	Mbetur pa shlyer Entit Kombëtar të Banesave për apartamentin	218.110
3	PASURI NETO (1-2)	861.668
4	TË ARDHURA	3.763.267
	Të ardhura, subjekti si prokuror	3.493.766
	Të ardhura nga puna e bashkëshortes	269.501
5	SHPENZIME	3.331.512
	Shpenzime jetese	3.031.512
	Shpenzime arredimi sipas pyetësorit nr. 2	300.000
	DIFERENCA (TË ARDHURA -PASURI-SHPENZIME 4-3-5)	-429.913

Në lidhje me këtë konstatim, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën.

Subjekti, në parashtrimet e tij, si dhe në seancën dëgjimore, ka sqaruar se në vitet 1993 – 1998 ka banuar në shtëpinë e vjehrrit të tij, z. H. K., e ndodhur në Rr. “****”, nr. ***, duke deklaruar se: “...për këtë shkak shpenzimet tona kanë qenë minimale. Kjo për shkak edhe të mundësisë dhe të mbështetjes që na krijonte familja prindërore e bashkëshortes time për krijimin e të ardhurave që do të shërbenin kur të merrnin strehim dhe të jetonim më vete... Në bazë të përlllogaritjes dhe të koeficientëve sipas periudhave të ndryshme kohore, duke mos marrë në konsideratë kursimet shtesë për shkak të mbështetjes ekonomike që përmendëm më lart, diferenca, të ardhura - shpenzime rezulton të jetë pozitive (në shumën 1.090.189,46 lekë). Pra, mundësia e shlyerjes së banesës në shumën 579.778 lekë ishte plotësisht e mjaftueshme dhe e ligjshme.” Subjekti ka vënë në dispozicion kartelat mjekësore të fëmijëve të tij, S. dhe R. Xh., të lëshuara nga Qendra Shëndetësore nr. ***.

Vlerësimi i Komisionit

Subjekti nuk vërtetoi të kundërtën e barrës së provës në lidhje me të ardhurat e pajustificuara nga burime të ligjshme, në shumën prej 429.913 lekësh, për periudhën 1994 – 2003. Shpjegimet e subjektit, si dhe dy kartelat mjekësore të paraqitura, nuk vërtetojnë kursime shtese për shkak të shpenzimeve më të ulëta të jetesës. Subjekti nuk paraqiti asnjë provë dhe dokument për të vërtetuar pretendimin sipas të cilit, diferenca të ardhura - shpenzime për periudhën para vitit 2003 ka qenë pozitive (në shumën 1.090.189,46 lekë).

Në lidhje me shumën e paguar për blerjen e apartamentit në vlerën prej 579.778 lekësh, në përfundim të procesit të rivlerësimit, subjekti nuk vërtetoi të ketë pasur të ardhura të ligjshme për krijimin e saj, për shkak se: (i) gjatë periudhës 1994 – 2003, kur është paguar shuma prej 361.668 lekësh, ka rezultuar me balancë negative në shumën prej 429.913 lekësh; (ii) në vitin 2004, kur është paguar shuma prej 54.085 lekësh, ka rezultuar me balancë pozitive; dhe (iii) në vitin 2005, kur është paguar shuma prej 164.024 lekësh, subjekti ka rezultuar me balancë negative në shumën prej 193.975 lekësh¹³.

Në përfundim, në lidhje me pasurinë apartament me sipërfaqe 117.13 m², me nr. 9/108, me adresë: Rr. “****”, *** u konstatua se, subjekti ka kryer deklarime të pamjaftueshme, sipas parashikimit të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, pasi:

- ka kryer deklarime të pasakta në lidhje me vlerën e pasurisë;
- nuk vërtetoi bindshëm mundësinë financiare me të ardhura të ligjshme për blerjen e saj,

¹³ Shihni tabelën përmbledhëse të analizës financiare.

sipas parashikimit të pikave 2 dhe 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

2. Shtëpi banimi, 3 x 84.3 m², Njësia Administrative Lukovë, fshati Borsh; viti 2008 – 2010; vlera: 9.200.000 lekë.

Burimi i krijimit: kredi, huamarrje dhe kursime familjare.

Pjesa takuese: 100 %.

ILDKPKI-ja, për këtë pasuri, ka konstatuar:

- Deklarim të pasaktë lidhur me periudhën e ndërtimit të shtëpisë 3-katëshe me sip. 252.9 m², në fshatin Borsh, Sarandë; subjekti deklaron ndërtimin e shtëpisë në vitet 2008 – 2010, ndërsa leja e ndërtimit, kontrata, akti i kolaudimit, etj., i përkasin periudhës 10.10.2010 – 11.9.2011.

- Mungon dokumentacioni justifikues ligjor për investimin e shumës 9.200.000 lekë në ndërtimin e shtëpisë: kontratë sipërmarrjeje, preventiv punimesh, situacion, aktkolaudimi dhe dokumentacioni justifikues financiar lidhur me likuidimet e situacioneve të punimeve.

- Pasaktësi/mosdeklarime lidhur me investimet e kryera në objektin “godinë banimi 3-katëshe”, lagjja “****”, fshati Borsh, përkatësisht në vitet 2008 deri në vitin 2011, sipas aktkolaudimit datë 13.9.2011, ndërtimi i objektit ka filluar më 18.10.2010 dhe përfundimi i punimeve më 11.9.2011.

- Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për burimin e krijimit të shumës 9.200.000 lekë, për ndërtimin e shtëpisë së banimit 3-katësh: hua e marrë në vitin 2009 në shumën 3.000.000 lekë; kontribut i prindërve të bashkëshortes në shumën 900.000 lekë.

A. Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri

2.1 ZVRPP-ja Sarandë¹⁴ konfirmon të regjistruar në emër të shtetasit Adnand Xhelili pasurinë nr. *** të llojit godinë banimi 3-katëshe me sip. të bazës 96 m², sip. të ndërtimit 84.39 m² dhe sip. të truallit 570 m², në fshatin Borsh, Sarandë.

2.2 OSHEE-ja¹⁵ konfirmon se shtetasi Adnand Xhelili është abonent në instancën Sarandë, me datë furnizimi të energjisë elektrike 30.10.2010.

2.3 Në lidhje me origjinën dhe periudhën e ndërtimit të kësaj pasurie nga aktet në dosje¹⁶ në rend kronologjik rezultojn të jenë kryer veprimet, si vijojnë:

2.3.1 Me AMTP nr. *** datë 1.10.1995, familjes së Sh. H. Xh. (babai i subjektit) i është dhënë në pronësi tokë me sipërfaqe 12 700 m², pjesë përbërëse e së cilës është dhe sipërfaqja pemëtoare prej 1 400 m².

2.3.2 ASHK-ja Sarandë informoi se në datën 25.9.2009, për sipërfaqen 1 400 m² pemëtoare, është lëshuar certifikatë pronësie për pasurinë me nr. *** në emër të z. Sh. H. Xh., e cila është ndarë në dy pasuri: në pasurinë nr. *** me sipërfaqe 570 m² (pemëtoare), dhe pasurinë nr. ***, me sipërfaqe 830 m² (pemëtoare).

2.3.3 Me kërkesën e datës 15.2.2010, subjekti ka kërkuar miratimin e lejes së ndërtimit të objektit 3-katësh në fshatin Borsh.

2.3.4 Me vendimin nr. ***, datë 27.5.2010, të KRRT-së të Komunës Lukovë, është miratuar studimi urbanistik pjesor dhe planimetrisë së sheshit të ndërtimit, për z. Adnand Xhelili.

¹⁴ Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 23.4.2019, nga ZVRPP-ja Sarandë në dosjen e Komisionit.

¹⁵ Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 15.3.2019, nga OSHEE-ja, në dosjen e Komisionit.

¹⁶ Shihni aktet në anekset 4/3 dhe 29, në dosjen e ILDKPKI-së dhe shkresë kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 1.11.2019, nga ASHK-ja Sarandë, në dosjen e Komisionit.

2.3.5 Me kontratë ndërtimi të datës 7.6.2010, midis investitorit Adnand Xhelili dhe shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k., kjo e fundit merr përsipër ndërtimin e objektit sipas projekt zbatimit në tërësi, me vlerë të punimeve sipas preventivit (preventiv i cili mungon të jetë bashkëngjitur me kontratën).

2.3.6 Me vendimin nr. ***, datë 25.9.2010, të KRRT-së të Komunës Lukovë, është miratuar sipërfaqja e sheshit të ndërtimit dhe sip. e ndërtimit 96 m², për z. Adnand Xhelili, për objektin “godinë banimi 3-katësh” në fshatin Borsh, nënshkruar në datën 15.10.2010. Me po këtë vendim, është miratuar leja e ndërtimit për objekt godinë banimi 3-katësh, dhënë subjektit ndërtues të shoqëria “****” sh.p.k., me investitor Adnand Xhelili, nënshkruar po në datën 15.10.2010.

2.3.7 Sipas aktit të kolaudimit të datës 13.9.2011 për objektin godinë banimi 3-katësh me investitor Adnand Xhelili, ndërtimi i objektit ka filluar më 18.10.2010 dhe përfundimi i punimeve më 11.9.2011. Në këtë aktkolaudimi pasqyrohet se sheshi i ndërtimit është në parcelën pronë e z. Adnan Sh. Xhelili, vërtetuar me vërtetimin hipotekor në datën 25.9.2009, ndërkohë që ky fakt nuk është i vërtetë, pasi në kohën e dhënies së sheshit dhe të lejes së ndërtimit, në vitin 2010, pasuria ka qenë e regjistruar në emër të babait të subjektit, z. Sh. Xh.

2.3.8 Me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 15.6.2012, subjekti i rivlerësimit ka blerë nga babai dhe nëna e tij Sh. dhe M. Xh., pasurinë pemëtoze me sipërfaqe 570 m², e cila u regjistrua në ZVRPP-në Sarandë në emër të subjektit si pasuria me nr. *** sipas certifikatës për vërtetim pronësie datë 22.6.2012. Kjo pasuri, mbi të cilën është ndërtuar objekti 3-katësh në Borsh, Sarandë, nuk është deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike vjetore për vitin 2012 dhe as në deklaratën “Vetting”.

2.3.9 Me urdhrin për regjistrimin fillestar nr. ***, datë 25.2.2014 të ZVRPP-së Sarandë, është urdhëruar regjistrimi i objektit 3-katësh në Borsh, Sarandë, në emër të subjektit dhe me certifikatat për vërtetim pronësie të datës 25.2.2014, në emër të tij janë regjistruar: (1) pasuria me nr. ***, apartament me sip. ndërtese 84.39 m² dhe sip. truallë 190 m²; (2) pasuria me nr. ***, apartament me sip. ndërtese 84.39 m² dhe sipërfaqe truallë 190 m²; (3) pasuria me nr. ***, apartament me sip. ndërtese 84.39 m² dhe sip. truallë 190 m².

2.3.10 Me vërtetimin datë 17.10.2016, të Njësisë Administrative Lukovë, vërtetohet se shtetasi Adnand Xhelili ka shlyer në mënyrë të përvitshme detyrimet e taksave vendore për këto pasuri.

Në përfundim të hetimit administrativ në lidhje me origjinën e fitimit të pronësisë dhe periudhën e ndërtimit të pasurisë, nga të gjitha provat e administruara si më sipër, ka rezultuar:

- Sa i takon dokumentacionit ligjor sipas të cilit subjekti është legjitimuar të ndërtojë objektin, ka pasur paqartësi në lidhje me faktet : (i) përse dokumentacioni paraprak, vendimi për shesh ndërtimi, leja e ndërtimit, si dhe procesverbali i kolaudimit, janë përpiluar e miratuar gjatë periudhës kur subjekti i rivlerësimit nuk e ka pasur titullin e pronësisë mbi sipërfaqen prej 570 m², (fituar në datën 15.6.2012) sipas detyrimit të parashikuar në nenin 45 të ligjit nr. 8405/1998, “Për urbanistikën”, i ndryshuar; dhe (ii) përse leja e ndërtimit dhe vendimi i KRRT-së për miratimin e sheshit të ndërtimit, janë nënshkruar në të njëjtën datë 15.10.2010.

- Sa i takon periudhës së ndërtimit të objektit, në kundërshtim me çka rezulton në dokumentet shkresore të administruara: (1) aktkolaudimi i datës 13.9.2011, sipas të cilit ndërtimi i objektit ka filluar në datën 18.10.2010 dhe ka përfunduar në datën 11.9.2011; (2) vendim për dhënie shesh ndërtimi dhe leje ndërtimi të KRRT-së të Komunës Lukovë nr. ***, datë 25.9.2010, ndërtimi i objektit është kryer pa pasur një leje ndërtimi të lëshuar nga organet kompetente gjatë periudhës 2008 – 2010, referuar provave si vijojnë:

- deklarimeve të subjektit për vitin 2009, ku është deklaruar një kredi dhe një hua për ndërtimin e objektit;
- deklaratës “Vetting”, ku është deklaruar ndërtimi i objektit në vitet 2008 – 2010;
- deklarimeve gjatë procesit të rivlerësimit, ku nga subjekti vijon të deklarohet ndërtimi i objektit në vitet 2008 – 2010, duke specifikuar fillimin e punimeve në fund të vitit 2008;
- informacionit të marrë nga OSHEE-ja, sipas të cilit furnizimi me energji elektrike i kësaj godine ka nisur në datën 30.10.2010, pra objekti është vënë në përdorim në këtë datë.

2.4 Nga deklaratimet e subjektit lidhur me këtë pasuri, u konstatua se:

- Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008 nuk është deklaruar asnjë fakt lidhur me pasurinë (truallin, fillimin e punimeve dhe shpenzime të kryera gjatë këtij viti).
- Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009 nuk është deklaruar asnjë fakt në lidhje me pasurinë dhe investimet e kryera në të. Në pjesën “detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” është deklaruar: *“Për rindërtimin e shtëpisë në vendlindje : (1) kontratë huamarrje në emër të bashkëshortes nr. ***, datë 8.6.2009, nga huadhënësi M. B., në shumën 3.000.000 lekë, pa interes; (2) kontratë kredie afatgjatë nr. ***, datë 11.11.2009, nga ‘Credins Bank’, marrë nga bashkëshortja M. Xh., në shumën 3.000.000 lekë. Afati: 11.12.2009 – 11.12.2024. Kësti mujor: 35.145 lekë”*.
- Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010 është deklaruar *“Një shtëpi banimi (dhe pushimi) në Borsh në truallin tim me burim financiar (kredi, huamarrje, kursime), si dhe kontributin e të gjithë pjesëtarëve të familjes, e paregjistruar në hipotekë. Vlera: 9.200.000 lekë”*, pa u deklaruar investime të kryera gjatë këtij viti.
- Në deklaratën “Vetting” është deklaruar: shtëpi banimi 3 x 84.3 m² në fshatin Borsh; vitet 2008 – 2010, në vlerën 9.200.000 lekë, me burim krijimi kredi, huamarrje, kursime familjare.
- Gjatë procesit të rivlerësimit subjekti u pyet në lidhje me periudhën e kryerjes së punimeve për ndërtimin e objektit, si dhe të vërë në dispozicion dokumente që vërtetojnë shpenzimet dhe investimet përkatëse (situacione, preventiva etj.). Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti konfirmoi deklarin në deklaratën “Vetting”, duke shpjeguar se *punimet kanë nisur në fund të vitit 2008 dhe kanë mbaruar në vitin 2010*. Ndërkohë, bashkëngjitur me përgjigjen, subjekti ka paraqitur vetëm një situacion punimesh në vlerën 7.620.950 lekë¹⁷, i cili është një dokument pa datë i cili nuk vërteton periudhën e kryerjes së punimeve dhe investimeve në objekt. Gjithashtu, subjekti nuk ka vënë në dispozicion asnjë mandatpagesë, faturë blerjeje apo faturë tatimore, për të vërtetuar shpenzime të kryera si dhe vlerën e investimeve në objekt, sipas këtij situacioni.

Për sa më sipër, në përfundim të hetimit administrativ, në deklaratimet e subjektit ka pasur paqartësi në lidhje me periudhat e investimit dhe ndërtimin e objektit.

2.5 Në lidhje me trajtimin preferencial, gjatë procesit të rivlerësimit janë kryer hetime edhe në lidhje me mundësinë e trajtimit preferencial të subjektit, në përfundim të të cilave nuk pati dyshime, referuar fakteve, si vijojnë:

- Edhe pse kontrata e sipërmarrjes me shoqërinë e ndërtimit “***” sh.p.k., është një kontratë formale, që nuk ka sjellë asnjë pasojë, u kryen hetime lidhur me konfliktin e interesit me këtë shoqëri dhe administratorin e saj. Me vërtetimet e lëshuara nga Prokuroria pranë Gjykatës së

¹⁷ Vlera sipas situacionit 7.620.950 lekë + 1 600 000 lekë, deklaruar ne pyetesorin standart si vlere arredimi = 9.220.950 lek, pothuajse as sa eshte deklaruar vlere e investimeve ne deklaraten vetting.

Rrethit Gjyqësor Tiranë¹⁸, vërtetohet se subjekti nuk ka shqyrtuar çështje ku shtetasi D. B. dhe shoqëria “****” sh.p.k., ka qenë palë pjesëmarrëse.

- Sipas udhëzimit nr.1, datë 20.8.2008, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2008, kostoja e ndërtimit në qytetin e Sarandës për vitin 2008 ka qenë 27.617 lekë/m² për sipërfaqe ndërtimi. Sipas kësaj reference, ndërtimi i kryer nga subjekti do të kushtonte 84.3 m² x 3kate x 27.617 lekë/m² = 6.984.339 lekë. Ndërkohë, subjekti ka deklaruar se vlera monetare e përdorur për ndërtimin e objektit është 7.620.950 lekë (9.200.000 lekë - 1.600.000 lekë për arredim), pra, rreth 600.000 lekë më shumë se vlerat e referencës sipas EKB-së.

Barra e provës që i ka kaluar subjektit në lidhje me konstatimet si më sipër, sipas nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, si dhe qëndrimi i tij për çdo gjetje gjatë parashtrimeve të datës 27.1.2020 dhe seancës dëgjimore:

1. Nga deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, duket se ka mospërputhje në deklarime, pasi në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar si kohë të ndërtimit të objektit periudhën 2008 – 2010, deklarime që përputhen me ato gjatë procesit të rivlerësimit, ndërkohë që, në deklaratën për vitin 2008 nuk është deklaruar asnjë fakt në lidhje me godinën, punimet dhe truallin e objektit.

Në lidhje me këtë konstatim, subjekti ka sqaruar: ... *kam deklaruar (në përgjigje të pyetësorit dy) se ndërtimi i shtëpisë ka filluar në vitin 2008 (në fund të tij) duke dashur të shpreh veprime përgatitore që kanë të bëjnë me organizimin dhe pastrimin e sheshit të ndërtimit, si dhe afrimin e disa materialeve inerte, punime që më së shumti janë kryer gjatë vitit 2009...*, por, ai nuk ka paraqitur asnjë dokument shkresor që të vërtetojë pretendimet e tij mbi investimet e kryera në objekt në periudhat përkatëse.

2. Duket se pasuria pemëtoare me sip. 570 m², përfituar me kontratën e shitblerjes nr. ****, datë 15.6.2012, nuk është deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012 dhe as në deklaratën “Vetting”.

Në lidhje me këtë konstatim, subjekti deklaroi se: ... *sipërfaqja prej 570 m² është pjesë përbërëse e sipërfaqes prej 1 400 m² në emër të kryefamiljarit Sh. Xh. Pas regjistrimit dhe pajisjes me certifikatë pronësie në emër të kryefamiljarit është bërë kalimi i pronësisë në emrin tim nëpërmjet një kontrate shitjeje nr. ****, datë 15.6.2012, të sugjeruar nga noterja si gjetja më e përshtatshme për kalimin e pronësisë së truallit në emrin tim. Lidhur me kalimin e pronësisë për shkak të bashkëpronësisë nga ana ime nuk është paguar asnjë vlerë monetare. Për këtë arsye, ky truall duke qenë pjesë përbërëse e sipërfaqes së deklaruar më parë në deklaratën vjetore të vitit 2009 e kam konsideruar të ezauruar logjikisht...*

3. Është e paqartë përse: (i) kërkesa e subjektit për miratimin e lejes së ndërtimit; (ii) studimi urbanistik pjesor dhe planimetrisë së sheshit të ndërtimit; (iii) kontrata e ndërtimit me shoqërinë ndërtuese; (iv) dhënia e sheshit të ndërtimit; (v) miratimi i lejes së ndërtimit; (vi) procesverbali i kolaudimit, janë përpiluar dhe miratuar gjatë periudhës kur subjekti i rivlerësimit nuk e ka pasur titullin e pronësisë mbi sip. 570 m², pronësi të cilën e ka fituar në datën 15.6.2012. Është e paqartë pse leja e ndërtimit dhe vendimi i KRTT-së për miratimin e sheshit të ndërtimit janë nënshkruar në të njëjtën datë, 15.10.2010.

Lidhur me këto paqartësi, subjekti nuk ka dhënë shpjegime, por ka vënë në dispozicion deklaratën noteriale nr. ****, datë 17.1.2020, të inxhinierit dhe administratorit të firmës “****” sh.p.k., z. D. B., sipas të cilës:

¹⁸ Shihni vërtetim nr. **** prot., datë 22.10.2019, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, në dosjen e Komisionit.

a. Punimet paraprake në objekt kanë nisur gjatë viteve 2008 - 2009, ndërkohë që zbardhja e lejes së ndërtimit, me të cilën subjekti nuk është penguar për vazhdimin e punës së nisur për objektin, është bërë në shtator të vitit 2010.

b. Kontrata e ndërtimit me subjektin ndërtues “****” sh.p.k., është lidhur për efekt të marrjes së lejes së ndërtimit, pa u shoqëruar me preventivin e saktë të punimeve, pasi nuk është rënë dakord për shkak të çmimeve dhe, për këtë arsye, ranë dakord që punimet të kryheshin nga vetë investitori Adnand Xhelili.

c. Sip. 570 m² ka qenë pjesë përbërëse e sip. 1 400 m² në pronësi të kryefamiljarit Sh. Xh., në të cilën z. Adnand Xhelili është bashkëpronar dhe nga marrëveshja brenda familjes ishte rënë dakord që kjo sipërfaqe do t'i kalonte në pronësi z. Adnand Xhelili.

ç. Leja e ndërtimit, vendimi i KRT-së, si dhe dokumentacioni shoqërues për tokat në pronësi të subjektit, jepeshin me një vendim të përbashkët, prandaj janë miratuar edhe në të njëjtën datë.

4. Duket se leja e ndërtimit dhe gjithë dokumentacioni mbështetës janë lëshuar pas ndërtimit të objektit. Ndërtimi është kryer pa një leje ndërtimi të miratuar nga organet kompetente ligjore dhe referuar nenit 76, të ligjit nr. 8405/1998, “Për urbanistikën”, i ndryshuar, subjekti ka kryer ndërtim të kundërligjshëm, hipotekimi dhe regjistrimi i të cilit nuk lejohej. Në bazë të sanksioneve parashikuar në ligjin nr. 8405/1998, “Për urbanistikën”, i ndryshuar, për ndërtimet e kundërligjshme, parashikohet pagesa e një gjobe, e cila nuk vërtetohet të jetë paguar nga subjekti i rivlerësimit.

Lidhur me këto konstatime, në parashtrimet e tij subjekti ka deklaruar shkurtimisht se: ... *deklarata noteriale e administratorit të firmës “****” sh.p.k., sqaron hollësisht në mënyrë kronologjike ecurinë ligjore të aplikimit dhe nxjerrjes së lejes së ndërtimit, si dhe hipotekimit të objektit. Nga ana e bashkisë dhe e komunës, nga shërbimet e inspektorateve përkatës nuk është konstatuar asnjë parregullsi që të bjerë ndesh me ligjin “Për urbanistikën” dhe në këto rrethana nuk është akorduar asnjë gjobë për ndonjë kundërvajtje administrative...*

Gjatë seancës dëgjimore subjekti ka qenë konfuz në deklaratimet në lidhje me periudhën e saktë të ndërtimit të objektit, duke mos dhënë një përgjigje konkrete dhe duke vijuar të deklarojë që punimet përgatitore të cilat kanë nisur në vitin 2008, kanë vijuar në vitin 2009, ndërsa shpenzimet për objektin i përkasin viteve 2008, 2009 dhe 2010.

Vlerësimi i Komisionit

Nga të gjitha provat e administruara, si dhe shpjegimet që subjekti ka paraqitur pas kalimit të barrës së provës, me të cilat nuk arriti të vërtetojë të kundërtën e gjetjeve të Komisionit, gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes, në lidhje me objektin tretatësh në fshatin Borsh, Sarandë, rezultoi e vërtetuar se:

- Vendimi për dhënie shesh ndërtimi dhe leja e ndërtimit janë lëshuar në datën 15.10.2010, periudhë në të cilën subjekti i rivlerësimit nuk e ka pasur titullin e pronësisë mbi sip. 570 m², në kundërshtim me nenin 45¹⁹, të ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998, “Për urbanistikën”, i ndryshuar, sipas të cilit, në rastin e pronës private është e detyrueshme paraqitja e kontratës së lidhur me pronarin e tokës.

¹⁹ Neni 45, i ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998, “Për urbanistikën”, i ndryshuar parashikon: “Çdo person fizik e juridik, vendas ose i huaj që do të ndërtojë në territorin e Republikës së Shqipërisë duhet të pajiset me leje ndërtimi. Ky është dokumentacioni i vetëm ligjor mbi bazën e të cilit lejohet ndërtimi. Leja e ndërtimit i jepet personit juridik ndërtues të licencuar. Si në rastin kur toka është pronë private, ashtu dhe kur ajo është pronë publike, personi juridik ndërtues duhet të paraqesë kontratën e lidhur me pronarin e tokës ose me personin që ka marrë sheshin e ndërtimit nga KRRT-ja...”.

- Kontrata me shoqërinë “***” sh.p.k., e datës 7.6.2010, është një kontratë e lidhur formalisht, e konfirmuar edhe nga subjekti²⁰, vetëm për t’u paraqitur pranë organeve kompetente me qëllim marrjen e lejes së ndërtimit. Si e tillë, vlerësohet se përmban elementë të fiktivitetit, sipas nenit 92²¹, të Kodit Civil dhe Vendimit Unifikues nr. 932, datë 22.6.2000²², të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, pasi marrëveshja e palëve kontraktore nuk ka pasur si qëllim që të sjellë pasoja juridike të ligjshme.

- Pasuria me nr. ***, truall me sip. 570 m², përfituar me kontratën e shitjes nr. ***, datë 15.6.2012, nuk është deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012 dhe në deklaratën “Vetting”, në kundërshtim me ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, dhe ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

- Objekti 3-katësh në fshatin Borsh, Sarandë është ndërtuar pa pasur një leje ndërtimi nga organet kompetente ligjore, sipas parashikimit të nenit 45, të ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998, “Për urbanistikën”, i ndryshuar, ndërtim i cili sipas nenit 78²³ të po këtij ligji është ndërtim i paligjshëm, bazuar në provat si vijojnë: (1) deklaratimet e subjektit për vitin 2009; (2) deklarimin e subjektit në deklaratën “Vetting” dhe ato gjatë procesit të rivlerësimit; (3) informacionin e OSHEE-së, sipas të cilit shpenzimet e energjisë elektrike kanë filluar në datën 30.10.2010 e në vijim; (4) deklarimin për vitin 2010, në të cilin subjekti ka deklaruar “të ardhura nga turizmi nga shfrytëzimi i shtëpisë për turizëm në Borsh”, fakt që vërteton se gjatë këtij viti objekti ishte në gjendje optimale për t’u përdorur.

Pretendimi i subjektit se nuk është konstatuar asnjë parregullsi në kundërshtim me ligjin nr. 8405, “Për urbanistikën” nga inspektorati i komunës dhe bashkisë, pasi nuk është vënë gjobë për ndërtimin pa leje, nuk e bën ndërtimin e objektit të kryer sipas rregullave në fuqi.

Për sa më sipër, në përfundim të procesit të rivlerësimit, lidhur me objektin 3-katësh në fshatin Borsh, Sarandë, subjekti ka kryer deklarime të pamjaftueshme, sipas pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, pasi:

- Nuk ka deklaruar pasurinë nr. ***, truall me sip. 570 m² në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012 dhe në deklaratën “Vetting”, në kundërshtim me parashikimet e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, të ligjit nr. 84/2016 (shtojca 2) dhe pikës 2 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

- Në deklaratat periodike vjetore për vitet 2008, 2009 dhe 2010, nuk ka deklaruar në lidhje me punimet ne objekt dhe investimet e kryera.

²⁰ Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2.

²¹ Neni 92, i Kodit Civil parashikon: “[...] Veprimet juridike të pavlefshme nuk krijojnë asnjë pasojë juridike. Të tilla janë ato që: [...] ç) bëhen në marrëveshje të palëve pa pasur për qëllim që të sjellin pasoja juridike (fiktive ose të simuluar)”.

²² Vendimi Unifikues nr. 932, datë 22.6.2000, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, parashikon: “Në rastet e fiktivitetit dhe të simulimit, mospërputhjen midis vullnetit dhe shfaqjes së tij e duan vetë palët e veprimit juridik. Veprimi juridik është i simuluar kur kryhet me qëllim që të mbulojë një veprim tjetër juridik, të vlefshëm apo të pavlefshëm, të cilin palët kanë dashur ta kryejnë me të vërtetë dhe që rezulton prej kundërdeklarimit si marrëveshje e fshehtë midis tyre.”

²³ Neni 78, i ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998, “Për urbanistikën”, i ndryshuar, parashikon: “Ndërtimet që kryhen pa leje ndërtimi në sheshin e miratuar, janë ndërtime të kundërligjshme. Seksioni i urbanistikës në bashki/komunë/qark, Drejtoria e Urbanistikës në Bashkinë e Tiranës, policia bashkiake dhe personat e tjerë të interesuar, kur vërejnë ndërtime të kundërligjshme, njoftojnë menjëherë inspektoratin ndërtimor e urbanistik të bashkisë/komunës/qarkut, i cili, pas marrjes së njoftimit ose me nismën e vet, vendos menjëherë pezullimin e ndërtimit të kundërligjshëm dhe masën përkatëse, sipas nenit 81 të ligjit “Për urbanistikën” dhe legjislacionit në fuqi.”

Në lidhje me konstatimin se subjekti ka kryer veprime që vijnë në kundërshtim me ligjin pasi ka lidhur një kontratë fiktive me shoqërinë “ *** “ sh.p.k., si dhe ka kryer ndërtim pa leje të organeve kompetente, Komisioni ka vlerësuar të mos i mbajë në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes, në respektim të parimit të proporcionalitetit, referuar faktit që kontrata e ndërtimit ka pasur për objekt ndërtimin e një godine mbi truallin në bashkëpronësi të subjektit si anëtar i familjes bujqësore, objekt për të cilin ai është pajisur me leje ndërtimi.

B. Hetimi i Komisionit në lidhje me burimin e krijimit të shumës prej 9.200.000 lekësh me të ardhura të ligjshme

Si burim krijimi të kësaj shume nga subjektit janë deklaruar: (1) kredi, pa përcaktuar shumën e kredisë dhe llojin e kredisë; (2) huamarrje, pa përcaktuar faktet lidhur me huan; (3) kursime familjare.

1. Analiza e burimit “kredi”:

Nga dokumentet dhe provat e administruara gjatë hetimit administrativ²⁴ rezultoi se:

1.1 Sipas kontratës për kredi afatgjatë nr. ***, datë 11.11.2009, me dorëzanës Adnand Xhelili, kredimarrësja M. Xh., ka marrë në “Credins Bank” kredi në shumën 3.000.000 lekë, me afat 180 muaj, me “qëllim respektiv” kreditim investim²⁵. Marrja e kredisë është deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009, me qëllim rindërtimin e shtëpisë në vendlindje.

1.2 Kredia është *disbursuar* nga “Credins Bank” në llogarinë e znj. M. Xh., me nr. ***, në datën 20.11.2009, në shumën 2.970.000 lekë, konfirmuar nga kjo bankë.²⁶

1.3 Znj. M. Xh., ka tërheqje të shumës së kredisë në data të ndryshme gjatë viteve 2009 dhe 2010. Por, nuk vërtetohen pagesa në rrugë bankare ndaj shoqërisë ndërtimore “****” sh.p.k.

Edhe pse gjatë hetimit administrativ nuk u vërtetua që shuma e kredisë të ketë kaluar në favor të shoqërisë ndërtuese, për shkak se kontrata me këtë shoqëri ka qenë formale, në vlerësimin tërësor të rrethanave dhe provave të administruara, Komisioni krijoi bindjen që kredia është marrë dhe është përdorur për investim në objektin 3-katësh në Borsh, dhe si e tillë, është marrë në konsideratë si e ardhur ligjore gjatë analizës financiare, pasqyruar në tabelën përmbledhëse.

1.4 Lidhur me shlyerjen e kredisë, në deklaratimet periodike vjetore subjekti ka deklaruar rregullisht shlyerjen në shumat përkatëse, si dhe pjesën e detyrimeve të pashlyera në deklaratat periodike vjetore që nga viti 2009 deri në vitin 2013 kur është bërë shlyerja totale e kredisë. Por, nga analiza financiare, në përfundim të hetimit administrativ, u konstatua se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare me të ardhura të ligjshme për likuidimin e kredisë.

Në përfundim të hetimit administrativ, me njoftimin e rezultateve të hetimit, në lidhje me kredinë e marrë në “Credins Bank”, subjektit i kaloi barra e provës, sipas nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, për të paraqitur prova ose shpjegime për të provuar të kundërtën, në lidhje me konstatimet, duket se: (i) nga analiza financiare subjekti nuk ka pasur mundësi për likuidimin e kësaj kredie me të ardhura të ligjshme, likuidim i cili është bërë brenda 4 viteve, ndërkohë që ishte marrë me afat 15-vjeçar; (ii) nuk vërtetohet që shuma e kredisë të ketë kaluar në favor të shoqërisë ndërtimore.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në ushtrim të barrës së provës

²⁴ Shihni aktet në aneksin 42/2, në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁵ Me kontratën e hipotekimit nr. ***, datë 11.11.2009, si garanci për shlyerjen e kredisë është vënë apartamenti me adresë: Rr. “****”, me sip. 117.13 m², në pronësi të shtetasve Adnand dhe M. Xh.

²⁶ Shkresa nr. *** prot., datë 11.4.2019, e “Credins Bank”.

- Në lidhje me moskalimin e kredisë në favor të shoqërisë “***” sh.p.k., subjekti deklaroi se: “... shoqërisë “***” nuk i ka kaluar asnjë vlerë monetare, pasi siç thamë shtëpia është bërë nga vetë investitori...” Për sa i takon këtij deklarimi, gjatë hetimit administrativ, u vërtetua që kontrata me këtë shoqëri ka qenë formale dhe nuk ka sjellë asnjë pasojë. Për këtë shkak, në favor të shoqërisë nuk ka kaluar asnjë shumë monetare.

- Në lidhje me mungesën e mundësisë financiare me të ardhura të ligjshme për shlyerjen e kredisë, subjekti pretendoi se likuidimi i kredisë në një afat kohor brenda 4 vjetësh është bërë e mundur nga: (1) të ardhurat nga pagat e tij dhe e bashkëshortes (viti 2008 – 2013, gjithsej në vlerën 10.108.134 lekë); (2) depozita e vëllait të bashkëshortes e vënë në dispozicion të shlyerjes së kredisë; (3) të ardhurat e nxjerra nga kulturat bujqësore, si dhe lëshimi i dhomave të shtëpisë gjatë stinës së verës, të deklaruara në mënyrë të përvitshme. Për seicilin prej këtyre burimeve të pretenduara, Komisioni ka kryer analizë të provave dhe fakteve, si vijon:

Së pari: në lidhje me të ardhurat e pretenduara nga pagat e subjektit dhe të bashkëshortes për vitet 2008 - 2013, këto të ardhura janë marrë në konsideratë duke u përfshirë në analizën financiare të kësaj periudhe.

Së dyti: në lidhje me pretendimin mbi të ardhurat ligjore nga depozita e vëllait të bashkëshortes, vënë në dispozicion të shlyerjes së kredisë, Komisioni konstatoi se subjekti i referohej një shume të dhënë hua nga kunati i tij, zoti A. K., në vitin 2011, për të cilën janë kryer veprime hetimore, si vijojne:

ILDKPKI-ja ka konstatuar mosdeklarim në deklarimin “Vetting” dhe në deklarimin e interesave private periodike vjetore 2011, të huas në shumën 18.594 USD (sipas DPPP), nga shtetasi A. K., qëllimin e përdorimit dhe burimin e krijimit.

Gjatë hetimit administrativ u konstatua se shtetasi A. K., kunati i subjektit, i ka dhënë një hua shumën 18.594 USD, e cila nuk është deklaruar në asnjë prej deklarimeve periodike dhe as në deklaratën “Vetting”. Në kuadër të veprimeve hetimore, në lidhje me këtë hua rezultoi:

a. DPPP²⁷ informoi në lidhje me një transaksion të raportuar në emër të bashkëshortes së subjektit znj. M. H. Xh. në datën 18.2.2011, në shumën 18.594 USD, me përshkrimin “derdhje”, në “Credins Bank” – hua e marrë nga shtetasi A. K.

b. Nga verifikimi në “Credins Bank”²⁸ u konstatua se shuma prej 18.594 USD ka kaluar në llogari të bashkëshortes së subjektit në datën 18.2.2011, prej z. A. K. me përshkrimin “hua nga A. K.” dhe në po këtë datë, kjo shumë është konvertuar në lekë dhe është përdorur për shlyerje të parakohshme të kredisë.

c. Subjekti, pasi u pyet në lidhje me këtë transaksion, si dhe në lidhje me burimin e krijimit të kësaj shume me të ardhura të ligjshme të z. A. K., në përgjigje të pyetësorit nr. 2, sqaroi se: ... ky transaksion është kryer për të shlyer një pjesë të kredisë meqenëse interesat e saj ishin të larta dhe se shtetasi A. K. është vëllai i bashkëshortes. Ai këtë shumë e ka pasur të depozituar në Bankën Amerikane të Shqipërisë në periudha të ndryshme kohore.... Lidhur me vërtetimin e të ardhurave të ligjshme të z. A. K., subjekti ka deklaruar se ky shtetas është edhe administrator i subjektit “***” sh.p.k., duke vënë në dispozicion ekstrakt historik nga QKB-ja, por jo dokumente që të vërtetojnë të ardhura ligjore të tij. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se bashkëshortja e zotit A. K. e quajtur A. K., ka përfituar shuma në vlerë monetare nga nëna e saj për shkak të shitjes së disa pasurive, por nuk ka paraqitur asnjë dokument shkresor për të vërtetuar këto pretendime. Ndërkohë, nga verifikimi i faqes online të QKB-së, nuk rezultoi të ketë të dhëna për të ardhura të ligjshme të shtetasit A. K.

²⁷ Shihni shkresën nr. *** prot., datë.12.3.2019, nga DPPP-ja në dosjen e Komisionit.

²⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 11.4.2019 nga “Credins Bank”.

Referuar fakteve si më sipër, në përfundim të hetimit administrativ, lidhur me huan e marrë prej z. A. K., u konstatua se : (i) subjekti nuk e ka deklaruar këtë hua dhe asnjë fakt lidhur me të, në asnjë prej deklarimeve periodike, sipas parashikimit të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, ‘Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë’, i ndryshuar, dhe as në deklaratën “Vetting” sipas shtojcës nr. 2 të ligjit nr. 84/2016; (ii) nuk vërtetohet me dokumentacion ligjor burimi me të ardhura të ligjshme i shumës prej 18.594 USD dhënë prej z. A. K.; (iii) për këto shkaqe, huaja nuk është marrë në konsideratë si burim i ligjshëm për shlyerjen e huas.

Bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën.

Në parashtrimet e tij subjekti ka sqaruar se : ... *lidhur me konstatimet e mësipërme, sqarojmë se siç edhe keni verifikuar, depozita e z. A. K. ka qenë e derdhur në periudha të ndryshme kohore 2006, 2007 dhe 2008 në Bankën Amerikane, por dhe nga shpjegimet plotësuese që janë dhënë pranë ILDKPKI në datën 29 mars 2016, tregon qartë vërtetësinë dhe ligjshmërinë e burimit të shumës. Duke qenë se veprimi ishte pasqyruar në Credins Bank, në procesverbalin e datës 29 mars 2016 e kemi konsideruar të hapur dhe transparent veprimin....* Ndërkohë, subjekti nuk ka vënë në dispozicion procesverbalin e pyetjes nga ILDKPKI-ja në datën 29.3.2016.

Në lidhje me ligjshmërinë e burimit të këtyre të ardhurave, subjekti pretendoi se z. A. K. ka pasur mundësi me të ardhura të ligjshme për të dhënë huan, duke vënë në dispozicion disa dokumente shkresore për të vërtetuar këtë pretendim.

Subjekti, pasi u pyet në seancën dëgjimore në lidhje me mospërmbushjen e detyrimit ligjor për të deklaruar huan dhe detyrimin financiar për shkak të huas ndaj z. A. K., vijoi të pretendojë se kalimi i huas ka qenë transparent, pasi është bërë në rrugë bankare nga z. A.K., ndërkohë që pranoi mosdeklarimin e huas si një pakujdesi gjatë plotësimit të deklaratës “Vetting”.

Vlerësimi i Komisionit

Pavarësisht përpjekjeve të subjektit për të vërtetuar me dokumente shkresore burimin e ligjshëm të të ardhurave të z. A. K. për të justifikuar dhënien e shumës prej 18.594 USD në vitin 2011, në përfundim të procesit të rivlerësimit, subjekti nuk arriti të kundërshtojë barrën e provës, për të vërtetuar huan në shumën prej 18.594 USD marrë nga z. A. K., si burim i ligjshëm për shlyerjen e kredisë, për shkak se:

- Subjekti nuk ka deklaruar në lidhje me këtë hua edhe detyrimin financiar ndaj shtetasit A. K. në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011 dhe në asnjë prej deklarimeve në vijim, sipas detyrimit ligjor parashikuar në nenin 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.

- Në deklaratën “Vetting”, subjekti nuk ka deklaruar huan dhe asnjë fakt në lidhje me shlyerjen e saj apo detyrimin financiar për shkak të saj, sipas detyrimit të parashikuar në nenin 30 dhe shtojcën nr. 2, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

- Mosdeklarimi sipas detyrimeve ligjore në deklaratat periodike vjetore dhe në deklaratën “Vetting”, i detyrimit financiar ndaj z. A. K., si dhe mungesa e deklarimeve në lidhje me shlyerjen e këtij detyrimi, do të thotë që subjekti e ka shlyer këtë hua. Vlen për t’u theksuar fakti që edhe gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti nuk ka ngritur pretendime në lidhje me shlyerjen ose jo të huas. Sa i takon mundësi për shlyerjen e huasë me të ardhura të ligjshme, edhe pse nuk ka të dhëna për periudhat/periudhën e shlyerjes së huas, nga analiza financiare ka

rezultuar se gjatë vitit 2011 kur është dhënë huaja, si dhe pas këtij viti, subjekti ka rezultuar me balanca negative, si rrjedhim, subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për shlyerjen e huas.

Për sa më sipër, subjekti ka kryer deklarime të pamjaftueshme në lidhje me huan prej 18.594 USD marrë nga z. A. K. në vitin 2011, sipas parashikimit të pikës 3, të nenit 61, të ligjit, dhe për rrjedhojë huaja nuk është konsideruar si burim i ligjshëm për shlyerjen e një pjese të kredisë marrë nga “Credins Bank”.

Se treti: në lidhje me pretendimin se të ardhurat e nxjerra nga kulturat bujqësore dhe nga shfrytëzimi i shtëpisë për turizëm në Borsh, kanë shërbyer si burim për shlyerjen e kredisë, gjatë hetimit administrativ janë kryer disa veprime hetimore me qëllim verifikimin e këtyre të ardhurave me burime të ligjshme, si vijon :

-Në deklaratën “Vetting”, në rubrikën të ardhura, subjekti ka deklaruar të ardhura nga toka bujqësore (vresht, ullinj dhe agrume në Borsh), kontribut i përbashkët familjar në vlerën 8.170.000 lekë, për të cilat ILDKPKI-ja ka konstatuar mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të vertetuar keto të ardhura, si dhe për shlyerjen e detyrimeve ndaj shtetit për tatimin në burim.

-Në deklaratimet periodike vjetore për vitet 2010 – 2016, subjekti ka deklaruar të ardhura nga toka bujqësore dhe nga shfrytëzimi i shtëpisë për turizëm në Borsh, shuma e të cilave në total prej 8.170.000 lekësh, është ajo e deklaruar në deklaratën “Vetting”.

Pasi u konstatua se ka mospërputhje në deklaratat periodike vjetore dhe në deklaratën “Vetting”, lidhur me burimin e të ardhurave, si dhe nga ILDKPKI-ja nuk është administruar asnjë provë në lidhje me të ardhurat konkrete të përfituara prej të dyja burimeve të deklaruara, subjektit iu kërkuan sqarime lidhur me mospërputhjen në deklarime, si dhe të dhëna mbi llojin e veprimtarisë që ka sjellë të ardhurat sipas secilës kategori. Gjithashtu, subjektit iu kërkua të vërtetojë me dokumente shkresore, pagimin e detyrimeve tatimore për të ardhurat e deklaruara, me qëllim legjitimitimin e tyre si të ardhura të ligjshme, bazuar në pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe në pikën 19, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016.

Në përgjigje të pyetësorit të dytë, subjekti nuk ka qartësuar dhe dokumentuar të ardhurat e deklaruara, si dhe nuk ka vënë në dispozicion asnjë dokument shkresor për të vërtetuar pagimin e detyrimit tatimor mbi të ardhurat nga kulturat bujqësore dhe turizmi, por ka deklaruar se *duke qenë banor i hershëm i Borshit në traditën e familjes dhe të formimit të tij arsimor, si i diplomuar edhe në Fakultetin e Agronomisë, ka qenë i lidhur me tokën dhe bujqësinë duke shfrytëzuar çdo hapësirë kohe e punuar si gjatë pushimeve, po ashtu edhe fundjavave së bashku me familjen te. ... , të ardhurat që buronin nga kjo punë ishin nga kulturat e ullirit kryesisht, të agrumeve, si dhe të vreshtit duke prodhuar një sasi të konsiderueshme prodhimesh.... këto të ardhura të deklaruara sipas viteve, nuk mund të konsiderohen fitime pasi përveç shlyerjes së pagesave të taksave vendore pranë Njesisë Administrative Lukovë, pjesa më e madhe e tyre kanë shkuar për mirëmbajtjen, punimin, ujitjen dhe plehërimin e kulturave. Për sa i përket shfrytëzimit sezonal të shtëpisë pasi është interesuar pranë Njesisë Administrative, është informuar se për atë pak hapësirë që shfrytëzonin, të gjithë banorët e kësaj Njësie e më tej deri atëherë nuk shlyenin asnjë detyrim. Bashkëngjitur me shpjegimet, subjekti ka vënë në dispozicion vërtetim e datës 17.10.2016, të lëshuar nga Njësia Administrative Lukovë, Bashkia Himarë, me të cilin vërtetohet se z. Adnand Xhelili ka shlyer në mënyrë të përvitshme detyrimet e taksave vendore.*

Në përfundim të hetimit administrativ, sipas nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e konstatimit, ku duket se: (i) ka mospërputhje në deklaratimet periodike vjetore dhe në deklaratën “Vetting”, në lidhje me burimin e krijimit të shumës prej 8.170.000 lekësh; (ii) nuk vërtetohen të ardhurat

e deklaruara në shumën prej 8.170.000 lekësh, si dhe krijimi i këtyre të ardhurave nga burime të ligjshme për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti, në parashtrimet e tij, si dhe gjatë seancës dëgjimore, pretendoi se:

- Ka deklaruar në mënyrë periodike të ardhura nga kulturat bujqësore, si dhe nga shfrytëzimi për turizëm gjatë stinës së verës i shtëpisë në fshatin Borsh. Sipas subjektit, mosdeklarimi i të ardhurave nga turizmi në deklaratën “Vetting” është thjesht një lapsus.

- Lidhur me të ardhurat e deklaruara në shumën prej 8.170.000 lekësh, subjekti ka sqaruar se *këto të ardhura konsiderohen të ligjshme, sepse burojnë nga puna e drejtpërdrejtë e familjes së tij në kohën e pushimit dhe gjatë lejes së zakonshme. Fakti i mospagimit të tatimit mbi fitimin është politikë e ndjekur nga pushteti vendor për stimulimin e agroturizmit në zonë. Kjo politikë është ndjekur dhe zbatuar në mënyrë uniforme për të gjithë banorët e kësaj bashkie, gjë të cilën e konfirmon edhe vërtetimi i lëshuar nga Bashkia Himarë, duke bashkëngjitur: (i) vërtetim nr. extra. prot., datë 17.1.2020, lëshuar nga Njësia Administrative Lukovë, Bashkia Himarë; dhe (ii) vërtetim nr. *** prot., datë 22.1.2020, lëshuar nga Bashkia Himarë, sipas të cilave konfirmohet fakti se subjekti ka shlyer në mënyrë të rregullt dhe të përvitshme taksat vendore pranë kësaj njësie administrative, por tatimi mbi të ardhurat nga kulturat bujqësore dhe dhënia e shtëpisë me qira gjatë muajve të verës nuk është vjelur, ashtu sikurse për të gjithë banorët e zonës, me qëllim favorizimin e agroturizmit.*

Vlerësimi i Komisionit

Sipas pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, subjektet e rivlerësimit kanë detyrimin të shpjegojnë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave, për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.

Së pari: lidhur me të ardhurat nga kulturat bujqësore, subjekti, përveç se nuk paraqiti asnjë dokument për të vërtetuar të kundërtën e barrës së provës, në përgjigje të pyetësorit nr. 2 ka deklaruar: *“Këto të ardhura të deklaruara sipas viteve, nuk mund të konsiderohen fitime, pasi përveç shlyerjes së pagesave të taksave vendore pranë Njesisë Administrative Lukovë, pjesa më e madhe e tyre kanë shkuar për mirëmbajtjen, punimin, ujitjen dhe plehërimin e kulturave”.*

Si rrjedhim, referuar këtij deklarami si dhe mungesës së dokumentacionit justifikues për vërtetimin e të ardhurave konkrete si dhe pagimin e detyrimeve tatimore pas kalimit të barrës së provës, Komisioni nuk konsideroi asnjë vlerë si të ardhur ligjore përfituar prej tokës bujqësore (vresht, ullinj dhe agrume në fshatin Borsh).

Së dyti: lidhur me të ardhurat nga turizmi, subjekti nuk paraqiti asnjë dokument për të vërtetuar të kundërtën e barrës së provës, pasi nuk vërtetoi pagimin e detyrimeve tatimore, me qëllim legjitimitimin e tyre si të ardhura të ligjshme. Përveç kësaj, deklarimi i të ardhurave nga turizmi për shkak të dhënies me qira të dhomave të objektit 3-katësh në fshatin Borsh, Sarandë, në periudhën 2010 – 2016, nënkupton ushtrimin e aktivitetit privat në fushën e turizmit, aktivitet për të cilin nuk u vërtetua që subjekti apo ndonjë prej anëtareve të familjes të jetë regjistruar në organet tatimore. Por, pavarësisht kësaj, në të dyja format që mund të ketë realizuar të ardhura, qoftë si individ, qoftë si subjekt tregtar, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin e pagimit të detyrimeve tatimore, bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” dhe ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, detyrim i cili nuk rezultoi të jetë përmbushur.

Vërtetimet e lëshuara nga Bashkia Himarë dhe Komuna Lukovë, të cilat konfirmojnë se mospagimi i tatimit mbi fitimin ka qenë politikë e pushtetit vendor për stimulimin e agroturizmit në zonë, përveç se nuk konfirmojnë që kjo politikë të ketë qenë e bazuar në një

akt ligjor/nënligjor, nuk kanë lidhje me subjektin e rivlerësimit, për sa kohë që nuk u vërtetua që subjekti dhe familjarë të tij të kenë qenë regjistruar si subjekte tregtare për ushtrimin e veprimtarisë private në fushën e agroturizimit.

Përveç sa më sipër, pagimi i taksave vendore për pasuri të ndodhura në fshatin Borsh, Sarandë, nga subjekti i rivlerësimit, nuk justifikon mospagimin e tatimit mbi të ardhurat e përfituara, sipas detyrimeve ligjore.

Lidhur me pretendimin sipas të cilit, të ardhurat nga kulturat bujqësore dhe turizmi nuk janë deklaruar dhe nuk janë përdorur si burim për krijimin e ndonjë pasurie, Komisioni konstatoi se, pavarësisht këtij fakti, mosmarrja në konsideratë e të ardhurave të deklaruara nga periudha 2010 – 2016, për shkak të mospagimit të detyrimeve tatimore, ka ndikuar në analizën financiare për të gjithë periudhën e rivlerësimit, gjatë të cilës subjekti ka rezultuar me një balancë negative prej 4.247.418 lekësh.

Në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, Komisioni konstatoi se subjekti ka kryer deklarime të pamjaftueshme në lidhje me të ardhurat nga kulturat bujqësore dhe nga dhënia e shtëpisë në fshatin Borsh për turizëm, parashikuar nga pika 3, e nenit 61, e ligjit nr. 84/2016, pasi:

- ka deklarime të pasakta në lidhje me këto të ardhura;
- nuk vërtetoi bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave në shumën 8.170.000 lekë, sipas pikave 2 dhe 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

Bazuar në sa më sipër, në lidhje me kredinë e marrë në “Credins Bank”, subjekti nuk vërtetoi të kundërtën e barrës së provës, pasi nuk vërtetoi mundësinë financiare të shlyerjes së saj me të ardhura të ligjshme.

2. Analiza e burimit “huamarrje”

Nga dokumentet e administruara gjatë hetimit administrativ²⁹, si dhe nga përgjigjet e pyetësorit nr. 2, rezultoi se:

2.1 Me kontratën e huamarrjes nr. ***, datë 8.6.2009, bashkëshortja e subjektit, znj. M. Xh., ka marrë nga huadhënësja M. B., jashtë zyrës noteriale, shumën prej 3.000.000 lekësh, me afat 5-vjeçar, pa interes, me qëllim ndërtimin e një shtëpie banimi në fshatin Borsh, Sarandë. Sipas kontratës, si garanci për kthimin e shumës, shërben ½ e pjesës së pasurisë së llojit apartament, me sip 117.13.m², e njëjta pasuri që është vënë si garanci edhe për kredinë, sipas kontratës së hipotekimit nr. ***, datë 11.11.2009.

Subjekti, pasi u pyet në lidhje me dorëzimin e huas, sqaroi se *marrja në dorëzim e huas është bërë nga bashkëshortja e tij në cash dhe po në atë mënyrë është kryer edhe likuidimi i saj*. Subjekti, gjithashtu, ka vënë në dispozicion një deklaratë të thjeshtë me shkrim dore, të korrikut të vitit 2016, të shtetasës M. B., e cila konfirmon deklaratimet e subjektit.

2.2 Nga deklaratimet periodike vjetore rezultoi se subjekti ka deklaruar marrjen e huas në vitin 2009, si dhe ka deklaruar rregullisht shlyerjen në shumat përkatëse dhe detyrimet e pashlyera, për vitet 2009 - 2014. Por, nga analiza financiare u konstatua që subjekti nuk ka pasur mundësi për shlyerjen e huas me të ardhura të ligjshme.

2.3 Bazuar në nenin 32/4, të ligjit nr. 84/2016, shtetasja M. B., në cilësinë e huadhënëses, është person i lidhur dhe, për këtë arsye, subjektit iu kërkua të vërtetojë me dokumente shkresore mundësinë financiare të saj me të ardhura të ligjshme për dhënien e huas. Gjatë procesit të rivlerësimit subjekti nuk ka vënë në dispozicion dokumente për të vërtetuar të ardhurat e kësaj shtetaseje, duke deklaruar se *sipas bashkëshortes së subjektit, znj. M. B., merrej me biznes*

²⁹ Shihni aktet në aneksin 42/1, në dosjen e ILDKPKI-së.

privat në fushën e karburanteve dhe tregtimin me shumicë dhe pakicë të gazit të lëngshëm dhe kishte mundësi financiare, dhe se bashkëshortja e tij kishte lidhje të hershme miqësore dhe shoqërore.

2.4 Nga verifikimi në QKB, znj. M. B. rezulton ortake me 68 % të aksioneve në shoqërinë “Polar” sh.p.k., e cila ka qenë pa aktivitet. Gjithashtu, ka qenë ortake me 33 % të aksioneve në shoqërinë “****” sh.p.k., e cila vetëm për vitin 2003 ka pasur një fitim të tatueshëm prej 2.264.228 lekësh, por nuk rezulton shpërndarje dividendi, ndërkohë që për vitet e tjera rezulton me qarkullim zero.

2.5 Në lidhje me një konflikt të mundshëm interesi, me huadhënëse M. B., Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë konfirmoi se z. Adnand Xhelili nuk ka shqyrtuar çështje ku kjo shtetase të ketë qenë palë pjesëmarrëse³⁰.

Në përfundim të hetimit administrativ, lidhur me huan prej 3.000.000 lekësh të marrë nga znj. M. B., sipas në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën në lidhje me konstatimet, nga të cilat duket se: (i) nuk vërtetohet që shuma prej 3.000.000 lekësh të këtë kaluar në favor të shoqërisë “****” sh.p.k; (ii) pavarësisht se huaja është deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009, nuk vërtetohet burimi i huas me të ardhura të ligjshme të huadhënëses; (iii) pasuria që është vënë si garanci për shlyerjen e kësaj huaje është vënë njëkohësisht si garanci edhe për marrjen e kredisë disa muaj më vonë, në datën 11.11.2009; dhe (iv) sipas analizës financiare, subjekti nuk ka pasur mundësi financiare me të ardhura të ligjshme për shlyerjen e huas.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit për çdo pretendim

Së pari: lidhur me kalimin e shumës së marrë hua nga znj. M. B. në favor të shoqërisë ndërtimore, subjekti deklaroi se *shoqërisë “****” sh.p.k., nuk i ka kaluar asnjë vlerë monetare, pasi siç thamë, shtëpia është bërë nga vetë investitori.* Për sa i takon këtij deklarimi, gjatë hetimit administrativ u vërtetua që kontrata me këtë shoqëri ka qenë formale dhe nuk ka sjellë asnjë pasojë. Për këtë shkak, nuk ka kaluar asnjë shumë monetare në favor të shoqërisë.

Së dyti: lidhur me faktin që pasuria e cila është vënë si garanci për shlyerjen e kësaj huaje, apartamenti i banimit në Tiranë, është vënë njëkohësisht si garanci edhe për marrjen e kredisë disa muaj më vonë, në datën 11.11.2009, subjekti pretendoi se *pasuria, e cila është vënë si garanci për huan dhe kredinë për shkak të vlerës së saj, i mbulonte dhe garantonte huamarrësin dhe kredihënësin, dhe se huadhënësja kishte rënë dakord dhe kishte shprehur mirëbesimin e saj lidhur me këtë garanci,* pretendim i cili u vlerësua bindës nga Komisioni, në kushtet kur huaja është shlyer dhe midis palëve nuk ka pasur konflikte.

Së treti: lidhur me mundësinë financiare, subjekti pretendoi që znj. M. B. ka pasur mundësi me të ardhura të ligjshme për të dhënë huan, duke vënë në dispozicion: (1) deklaratë noteriale datë 20.1.2020 të shtetases M. B. në të cilën konfirmon dhënien e huas; (2) vërtetim për të ardhurat bruto të shtetases M. B. dhe të bashkëshortit K. B., sipas shkresës nr. *** prot., datë 23.1.2020, nga Arkivi Qendror i Institutit të Sigurimeve Shoqërore; (3) ekstrakt të regjistrimit tregtar dhe bilancin financiar të shoqërisë “****” sh.a., administrator i të cilës është z. K. B.; (4) shkresë kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 24.1.2020, nga DRT-ja Tiranë mbi pagesën e tatim-fitimit për vitet 2004 – 2009; si dhe (5) formularët e deklarimit në lidhje me subjektin “****” sh.a.

Referuar këtyre akteve shkresore u konstatua se të ardhurat nga pagat e znj. M. B. dhe bashkëshortit K. B., për periudhën 2004 – 2009, kanë qenë në shumën totale prej 6.220.504 lekësh, pasqyruar në tabelën më poshtë:

³⁰ Shihni vërtetimin nr. *** prot, datë 22.10.2019, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në dosjen e Komisionit.

	2004	2005	2006	2007	2008	2009	TOTAL
K. B., paga <i>bruto</i>	130.314	285.504	360.000	682.822	839.100	941.400	3.239.140
M. B., paga <i>bruto</i>	135.000	163.042	240.000	662.822	839.100	941.400	2.981.364
							6.220.504

Ndërkohë, dokumentet e sipërpërmendura konfirmojnë se fitimi i shoqërisë “****” sh.a., për periudhën 2004 – 2009, ka qenë në shumën 162.170.783 lekë, por nuk rezulton shpërndarje dividendi. Nga kërkimi në faqen e internetit të QKB-së rezultoi se kompania “****” sh.a., nuk ka shpërndarë fitim deri në vitin 2009, por fitimin e ka kaluar në kapital. Në këto kushte, shuma prej 162.170.783 lekësh nuk është konsideruar si e ardhur ligjore.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, edhe pse Komisioni nuk mundi të arrijë në një konkluzion të saktë dhe përfundimtar në lidhje me mundësinë financiare të bashkëshorteve M. dhe K. B., që me të ardhurat nga pagat në shumën prej 6.220.504 lekësh të kenë përballuar shpenzime të jetesës gjatë viteve 2004 - 2009, si dhe t’i kenë dhënë huan prej 3.000.000 lekësh znj. M. Xh. në vitin 2009, nisur nga deklaratimet e sakta të subjektit në lidhje me këtë hua dhe në vlerësimin tërësor të çështjes, trupi gjykues çmoi të konsiderojë këtë hua si burim të ligjshëm të investimit në objektin 3-katësh në fshatin Borsh, Sarandë.

Së katërti: lidhur me konstatimin që sipas analizës financiare subjekti nuk ka pasur mundësi financiare me të ardhura të ligjshme për shlyerjen e huas prej 3.000.000 lekësh, marrë nga znj. M. B., subjekti ka pretenduar se burimet kanë qenë të mjaftueshme, duke iu referuar të ardhurave ndihmëse nga turizmi dhe kulturat bujqësore në fshatin Borsh, Sarandë, të ardhura të cilat nuk janë marrë në konsideratë si e ardhur e ligjshme, trajtuar si më sipër.

3. Lidhur me burimin “kursime familjare”

Nga analiza financiare rezultoi se subjekti nuk ka pasur mundësi të krijojë kursime familjare me të ardhura të ligjshme, që të kenë shërbyer si burim për investim në pasuri.³¹

C. Analiza financiare për pasurinë në fshatin Borsh, ndërtuar në periudhën 2008 – 2010

Me qëllim vlerësimin e mundësisë financiare me të ardhura të ligjshme të subjektit dhe personave të lidhur me të, për investimin në vlerën e deklaruar prej 9.200.000 lekësh gjatë hetimit administrativ, ka qenë i domosdoshëm përcaktimi i viteve në të cilat subjekti ka kryer investime mbi pasuri. Në lidhje me periudhën e investimeve, Komisioni çmoi që të konsiderojë vitet 2009 dhe 2010 si vite gjatë të cilave janë kryer shpenzime në objekt, referuar deklaratimeve periodike dhe deklaratës “Vetting” të subjektit, të cilat, në kuptim të pikës 5, të nenit 32, konsiderohen si prova, si vijojnë:

a. Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar si periudhë ndërtimi të objektit 2008 - 2010, fakt që u vërtetua me prova, dokumente shkresore, si dhe me deklaratimet e subjektit gjatë hetimit administrativ.

b. Gjatë procesit të rivlerësimit subjekti pretendoi fillimin e punimeve përgatitore në fund të vitit 2008, por në deklaratën periodike vjetore për këtë vit, subjekti nuk ka kryer asnjë deklaram në lidhje me fillimin e punimeve dhe shpenzimet për kryerjen e veprimeve përgatitore në objekt. Po kështu, deri në përfundim të procesit të rivlerësimit, subjekti nuk paraqiti asnjë provë dhe dokument për të vërtetuar llojin e punimeve dhe shpenzimet e kryera në fund të vitit 2008, fakte të cilat tregojnë se gjatë kësaj periudhe, subjekti mund të ketë kryer veprime për përgatitjen e terrenit për ndërtim, si pastrim territori, etj, veprime për të cilat nuk ka kryer

³¹ Shihni tabelën përmbledhëse të analizës financiare.

shpenzime monetare. Në këto kushte, Komisioni vlerësoi që gjatë analizës financiare për vitin 2008 të mos llogariten shpenzime për ndërtimin e objektit.

c. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009 subjekti ka deklaruar: (i) kredi në shumën 3.000.000 lekë, marrë në “Credins Bank”, nga e cila, referuar veprimeve bankare, vetëm shuma prej 500.000 lekësh është tërhequr në vitin 2009; si dhe (ii) hua në shumën 3.000.000 lekë, marrë nga znj. M. B..

Referuar këtyre fakteve, Komisioni vlerësoi që për efekt të analizës financiare, si kosto ndërtimi të objektit për vitin 2009 të llogaritet shuma prej 3.500.000 lekësh (500.000 lekë pjesë e kredisë + 3.000.000 lekë hua nga znj. M. B.) dhe pjesa e mbetur prej 5.700.000 lekësh të llogaritet si kosto investimi për vitin 2010.

Lidhur me burimin e ligjshëm për krijimin e pasurisë, gjatë analizës financiare, në përfundim të hetimit administrativ, janë marrë në konsideratë: (i) kredia prej 3.000.000 lekësh marrë në “Credins Bank”; si dhe (ii) të ardhura të dokumentuara nga puna e subjektit dhe e bashkëshortes, ndërkohë që nuk është marrë në konsideratë huaja prej 3.000.000 lekësh, marrë nga znj. M. B., për shkak se subjekti nuk kishte vërtetuar burimin e ligjshëm të shumës së marrë hua. Nga kjo analizë, përmbledhur në tabelën më poshtë, duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për ndërtimin e shtëpisë në fshatin Borsh, për shkak të një difference me të ardhura të pajustificuara në shumën prej 2.215.831 lekësh për vitin 2009 dhe në shumën prej 1.974.731 lekësh për vitin 2010.

	Përshkrimi	2009	2010
1	PASURI	6.217.485	2.397.543
	Shtëpi banimi në fshatin Borsh në truallin e subjektit	3.500.000	5.700.000
	SHTESA/PAKËSIME/LIKUIDITETE	2.717.485	-3.302.457
2	DETYRIME	3.000.000	-548.421
	Shlyerje huaje, znj. M. B.	0	-500.000
	Kredi “Credins Bank”	3.000.000	-48.421
3	PASURI NETO (1-2)	3.217.485	2.945.964
4	TË ARDHURA	1.685.687	1.878.852
	Të ardhura, subjekti si prokuror	1.038.404	1.133.709
	Të ardhura, subjekti si pedagog në universitet privat (nga banka)	39.600	47.610
	Të ardhura nga puna e bashkëshortes	607.683	697.533
5	SHPENZIME	684.033	907.619
	Interesa kredi “Credins Bank” 3.000.000 lekë	50.818	337.958
	Shpenzime jetese	546.480	546.480
	Shpenzime udhëtimi	86.735	23.181
	DIFERENCA (TË ARDHURA – PASURI - SHPENZIME 4-3-5)	-2.215.831	-1.974.731

Me njoftimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e këtij konstatimi.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit për çdo pretendim

Së pari: subjekti, në parashtrimet e tij, ka sqaruar se ndarja në dy vite e shumës prej 9.200.000 lekësh nuk është e drejtë, pasi shpenzimet për blerjen e materialeve kanë filluar që në vitin 2008, dhe përveç shumës së marrë hua dhe kredi, ka pasur edhe kursime të këtyre tri viteve, depozita në “Raiffeisen Bank” në emrin e subjektit, si dhe kursime të bashkëshortes.

Siç vërehet, pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendon se gjatë vitit 2008 ka kryer shpenzime për blerjen e materialeve, por, nuk paraqiti asnjë provë që të vërtetojë këtë pretendim apo kryerjen e ndonjë investimi konkret, investime për të cilat, ashtu sikurse është konstatuar edhe gjatë hetimit administrativ, subjekti nuk ka kryer deklaratime, si në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008, ashtu edhe në deklaratën “Vetting”. Në keto kushte, gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes, Komisioni e vlerësoi pretendimin si të pabazuar.

Së dyti: lidhur me huan e marrë nga znj. M. B., pasi subjekti paraqiti prova dhe dokumente në lidhje me të ardhurat e ligjshme të saj, Komisioni vlerësoi që kjo hua të konsiderohet si burim i ligjshëm për investimin mbi pasurinë (trajtuar si më sipër).

Së treti: lidhur me të ardhurat nga kulturat bujqësore dhe nga turizmi, subjekti nuk vërtetoi ligjshmërinë e tyre (trajtuar si më sipër) dhe, si rrjedhim, ato nuk janë përfshirë si e ardhur ligjore gjatë analizës financiare përfundimtare.

Për sa më sipër, gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes, për shkak të marrjes në konsideratë të huas prej 3.000.000 lekësh nga huadhënësja M. B., si burim i ligjshëm për investimin në pasuri, pas kalimit të barrës së provës, analiza financiare për vitin 2009 ndryshoi nga -2.215.831 lekë në +784.169 lekë, ndërsa balanca negative për vitin 2010 nuk ndryshoi. Si rrjedhim, subjekti nuk ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për investimin prej 9.200.000 lekësh në objektin 3-katësh në fshatin Borsh, Sarandë, për shkak të një difference të pajustificuar me të ardhura të ligjshme në shumën 1.974.731 lekë.

3. Depozitë bankare në shumën 1.066.395 lekë në “Raiffeisen Bank”.

Burimi i krijimit: kursime.

Pjesa takuese: 100 %.

Gjatë hetimit administrativ kjo depozitë është verifikuar me shkresën nr. *** prot., datë 26.2.2019, të “Raiffeisen Bank”.

4. Gjendje *cash* në shumën 1.200.000 lekë.

Burimi i krijimit: kursime familjare.

Pjesa takuese: 100 %.

Nga analiza financiare e viteve 2015 dhe 2016, në të cilat është krijuar ky likuiditet, subjekti ka rezultuar me një balancë negative prej 165.000 lekësh (në vitin 2015).

5. Tokë arë, me sip. 12.000 m², në fshatin Borsh, Sarandë.

Burimi i krijimit: ligji nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”, si anëtar i familjes bujqësore.

Pjesa takuese: 35 %.

Në lidhje me këtë pasuri, gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se:

5.1 ZVRPP-ja³² Sarandë nuk konfirmon të regjistruar pasurinë tokë arë në emër të subjektit.

5.2 Subjekti³³, pasi i janë kërkuar sqarime në lidhje me pjesën takuese 35 %, si dhe të vërtetojë me dokument shkresor bashkëpronësinë mbi këtë pjesë, nuk ka dhënë sqarime, por ka vënë në

³² Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. ***prot., datë 23.4.2019, nga ZVRPP-ja Sarandë, në dosjen e Komisionit.

³³ Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit.

dispozicion 8 certifikata për vërtetim pronësie të 8 pasurive të paluajtshme, regjistruar sipas AMTP-së nr. 157, në emër të z. Sh. H. Xh., si përfaqësues i familjes bujqësore. Sipas certifikatës së gjendjes familjare datë 1.8.1991, subjekti Adnan Xhelili është pjesë përbërëse e gjendjes familjare.

5.3 Subjekti ka bërë deklaram të pasurisë në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009: “...me hyrjen e zonës në sistem, regjistruar në emër të familjes bujqësore me kryefamiljar Sh.Xh., tokë sipas ligjit nr. 7501, me sip. 12.000 m², aktualisht në bashkëpronësi të gjithë familjes bujqësore, sipas frymëve, mua si familje më takon 1/3, d.m.th. 4.000 m².”

Për këtë pasuri nuk ka pasur problematika dhe dyshime.

Deklaratë e pasurisë së personit të lidhur, znj. M. Xh., bashkëshortja e subjektit, e cila ka plotësuar autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave, ku ka deklaruar se ka pasuri veçmas të regjistruar në emrin e saj, si më poshtë:

- Depozitë bankare në shumën 600.000 lekë, në “Credins Bank”.

Burimi i krijimit: kursime.

Pjesa takuese: 100%.

Kjo depozitë është verifikuar me shkresën nr. *** prot., datë 11.4.2019, të “Credins Bank”.

Deklaratë e pasurisë së personit të lidhur, z. R. Xh., djali i subjektit, i cili ka plotësuar autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave, ku ka deklaruar se ka pasuri veçmas të regjistruar në emrin e tij, si më poshtë:

1. Automjet i blerë me kontratën nr. ***, datë 28.6.2013, me vlerë 210.000 lekë.

Burimi i krijimit: kursime të familjes.

Pjesa takuese: 100 %.

Në lidhje me këtë pasuri, gjatë hetimit administrativ, u konstatua se:

1.1. DPSHTRr-ja³⁴ konfirmon se shtetasi R. Adnand Xhelili ka të regjistruar automjetin me targa ***, blerë me kontratën nr. ***, datë 28.6.2013, në shumën 210.000 lekë.

1.2 Kjo pasuri është deklaruar në deklarinimin periodik vjetor të vitit 2013: “Automjet me blerës djalin e subjektit R. Xh., me kontratën nr. ***, datë 28.6.2013, në vlerën 210.000 lekë”, por pa u deklaruar burimi i krijimit të pasurisë.

1.3 Në lidhje me burimin e krijimit “kursime te familjes”

Për të verifikuar mundësinë e blerjes me kursime familjare, është kryer analiza financiare deri në datën 28.6.2013 kur është blerë automjeti si në tabelën më poshtë, ku subjekti rezulton me një balance negative prej -1.126.664 lekesh.

	Përshkrimi	Deri në datën 28.6.2013
1	PASURI	262.930
	Automjet “Volkswagen Golf”, me targa ***	210.000
	Shtesa likuiditete	52.930
2	DETYRIME	-1.577.373
	Shlyerje hua, znj. M. B.	-600.000
	Shlyerje kredi në “Credins Bank”	-977.373

³⁴ Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. ***prot., datë 20.2.2019, dhe shkresën kthim-përgjigje nr. ***prot., datë 27.2.2019, nga DPSHTRr-ja, në dosjen e Komisionit.

3	PASURI NETO (1-2)	1.840.303
4	TË ARDHURA	1.028.554
	Të ardhura, subjekti si prokuror	553.021
	Të ardhura, subjekti si pedagog në universitet privat (nga banka)	103.500
	Të ardhura nga puna e bashkëshortes	372.033
5	SHPENZIME	314.915
	Interesa kredi në "Credins Bank" 3,000,000 lekë	32.867
	Shpenzime jetese	282.048
	DIFERENCA (TË ARDHURA -PASURI-SHPENZIME 4-3-5)	-1.126.664

Në përfundim të hetimit administrativ, subjektit i ka kaluar barra e provës për të vërtetuar të kundërtën, sipas nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, për konstatimet, duket se: (i) subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit në deklaratën periodike vjetore për vitin 2013; (ii) subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e automjetit, shlyerjen e detyrimeve dhe kryerjen e shpenzimeve, për shkak të një balance negative prej 1.126.664 lekësh.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe qëndrimi i Komisionit lidhur me pretendimet e tij

Subjekti, në parashtrimet tij, si dhe në seancë dëgjimore, nuk vërtetoi të kundërtën e barrës së provës, për shkak se:

Së pari: subjekti nuk ka dhënë shpjegime në lidhje me mosdeklarimin e burimit të krijimit të automjetit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013.

Së dyti: në lidhje me të ardhurat e pajustificuara në shumën prej 1.126.664 lekësh, subjekti ka deklaruar se *analiza financiare për të ardhurat deri në momentin e blerjes së automjetit në datën 28.6.2013 nuk është e drejtë, pasi të ardhurat për të gjithë vitin 2013 përbëhen nga: Të ardhurat e subjektit në shumën 1.108.813 lekë, të ardhurat e subjektit nga mësimdhënia në shumën 246.000 lekë, të ardhurat e bashkëshortes në shumën 741.516 lekë, të ardhurat nga lëshimi i shtëpisë për turizëm, si dhe nga kulturat bujqësore në shumën 1.350.000 lekë, të cilat, së bashku shkojnë në shumën 3.446.329 lekë. Kundrejt këtyre të ardhurave për këtë vit janë shlyer detyrimet ndaj huas së znj. M. B. në shumën 600.000 lekë, është shlyer kredia në "Credins Bank" në shumën 977.373 lekë, si dhe blerja e makinës së djalit në shumën 210.000 lekë.*

Pretendimi i subjektit se në analizën financiare duhen marrë në konsideratë të ardhurat e gjithë vitit nuk qëndron, pasi të ardhurat e realizuara pas momentit të blerjes së automjetit nuk mund të konsiderohen si të përdorura për blerjen e automjetit. Ndërkohë, të ardhurat e pretenduara prej subjektit nga pagat, janë marrë në konsideratë gjatë analizës financiare deri në momentin e blerjes së automjetit. Lidhur me pretendimin për të ardhurat nga turizmi dhe kulturat bujqësore ato nuk janë përfshirë në analizën financiare, për shkaqe të trajtuara me sipër.

Në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, në lidhje me pasurinë autoveturë me targa ***, u konstatua se janë kryer deklarime të pamjaftueshme, sipas pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, pasi:

- Nuk është deklaruar burimi i të ardhurave për blerjen e automjetit në vitin 2013, sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar.

- Nuk u vërtetua bindshëm burimi financiar me të ardhura të ligjshme për blerjen e automjetit, sipas pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

2. Depozitë në shumën 261.490,76 lekë në “Raiffeisen Bank”.

Burimi i krijimit: para të grumbulluara nga familja dhe të afërmit e tyre ndër vite, që nga lindja. Pjesa takuese: 100 %.

Kjo depozitë është verifikuar me shkresën nr. *** prot., datë 26.2.2019, të “Raiffeisen Bank”.

Deklaratë e vajzës së subjektit të rivlerësimit, znj. S. Xh., e cila ka plotësuar autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave, ku ka deklaruar se nuk ka pasuri veçmas të regjistruar në emrin e saj.

KONSTATIME TË TJERA

1. Në shkresën “kthim përgjigje për plotësim të dhënash”³⁵ të datës 20.5.2011, të cilën subjekti Adnand Xhelili ia ka drejtuar ILDKPKI-së, lidhur me pasurinë shtëpi banimi në fshatin Borsh, ka deklaruar si burim krijimi, përveç kredisë dhe huas, edhe shumën prej 900.000 lekësh, si kontribut i bashkëshortes nga kursimet e saj dhe të ardhura të dhëna nga familja e saj prindërore për qiratë e marra në Tiranë nga pronat e tyre.

Gjatë hetimit administrativ, subjekti u pyet lidhur me këtë burim dhe përfitimin e shumës 900.000 lekë me të ardhura ligjore. Në përgjigjen e pyetësorit nr. 2 subjekti pretendoi se nga kjo shumë: (i) shuma prej 300.000 lekësh është kontribut i bashkëshortes nga kursimet e saj; (ii) shuma prej 600.000 lekësh është përfituar nga familja e saj, por nuk ka dhënë sqarime mbi periudhën kohore kur është marrë kjo shumë dhe nuk ka sqaruar burimin e ligjshëm të dhuruesve.

Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera, për të provuar të kundërtën në lidhje me konstatimin, ku duket se: (i) subjekti nuk ka deklaruar kursimet e pretenduara prej 300.000 lekësh nga bashkëshortja, sipas detyrimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 dhe të ligjit nr. 84/2016; (ii) nuk është vërtetuar burimi i ligjshëm i shumës prej 600.000 lekësh, i pretenduar si përfitim nga prindërit e bashkëshortes, e cila nuk është deklaruar, sipas detyrimeve të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 dhe të ligjit nr. 84/2016; dhe (iii) si rrjedhim, ato nuk janë marrë në konsideratë si burim i ligjshëm i investimit në pasuri.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Subjekti, në parashtrimet e datës 27.1.2019, ka pretenduar:

- Në lidhje me shumën prej 300.000 lekësh, *kjo shumë ishte nga të ardhurat nga kursimet e bashkëshortes dhe të fëmijëve nga viti 2004 e në vazhdim.*

- Në lidhje me shumën prej 600.000 lekësh, *kjo shumë i është dhuruar bashkëshortes së subjektit nga prindërit e saj, si mbështetje financiare për ndërtimin e shtëpisë, ku mundësitë e krijimit të kësaj shume janë të dukshme dhe vërtetohen nga deklaratimet e të vëllait, z. A. K., sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 23.1.2020, pasi prona që përmendet është e nënës F. K., me të cilën vëllai (i bashkëshortes z. A. K.) bashkëjeton, por nuk ka paraqitur dokument për të vërtetuar dhurimin.*

Në lidhje me mosdeklarimin e shumës prej 900.000 lekësh në deklaratat periodike vjetore përkatëse dhe në deklaratën “Vetting”, është pranuar nga subjekti si pakujdesi, që nuk ka pasur për qëllim fshehjen, por thjesht ka qenë një harresë.

³⁵ Shihni shkresën nga z. Adnand Xhelili, drejtuar ILDKPKI-së në datën 20.5.2011, në aneksin 42/4, në dosjen e ILDKPKI-së.

Vlerësimi i Komisionit

Së pari: në lidhje me pretendimin se shuma prej 300.000 lekësh ka burim kursime të bashkëshortes së subjektit, Komisioni arsyeton se kursimet e saj, si dhe të të gjithë familjes, me burim të ardhura të ligjshme, janë marrë në konsideratë gjatë analizës financiare.

Së dyti: në lidhje me shumën prej 600.000 lekësh, pavarësisht përpjekjeve të subjektit për të argumentuar burimin e ligjshëm të kësaj shume, duke qënë se kjo shumë nuk është deklaruar në deklaratat periodike vjetore përkatëse, dhe aq më tepër kjo shumë nuk është deklaruar në deklaratën “Vetting” si burim investimi në objektin trekatësh në fshatin Borsh, Sarandë, sipas parashikimit të pikave 2 dhe 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe shtojcës nr. 2, të ligjit nr. 84/2016, kjo shumë nuk është marrë në konsideratë si e ardhur ligjore që ka shërbyer për investimin në objekt.

2. Në lidhje me adresat e banimit

- Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar si adresë të regjistrimit në gjendjen civile adresën: Rr. “***”, nd. ***, h. ***, ap. ***, Njësia Bashkiake Nr. ***, Tiranë, si dhe vendqëndrim tjetër me adresë: Njësia Administrative Lukovë, fshati Borsh, Bashkia Himarë.

- Në deklaratat periodike vjetore për vitet 2003 - 2009, si adresë e plotë banimi deklarohet Rr. “***”, ***, nr. ***.

- Në deklaratat periodike vjetore për vitet 2010 – 2016, subjekti ka deklaruar si adresë të regjistrimit në gjendjen civile Rr. “***” nd. ***, h. ***, ap. ***, Njësia Bashkiake Nr. ***, Tiranë.

Duke qënë se në adresën Rr. “***”, nuk ka ndonjë pasuri të deklaruar prej tij, subjektit iu kërkuan sqarime në lidhje me këtë adresë, dhe në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, vuri në dispozicion përgjigjen e Njesisë Bashkiake Nr. ***³⁶, e cila konfirmon se shtetasi Adnand Xhelili, sipas adresarit të ri, ka adresën Rr. “***”, nd. ***, h. ***, ap. ***, ndërsa, referuar regjistrin të gjendjes civile ky shtetas figuron me adresë: Rr. “***, ***, p. *** dhe të dyja këto adresa identifikojnë të njëjtën pasuri me nr. ***, z. k. ***.

ANALIZA FINANCIARE

Gjatë hetimit administrativ, me ndihmën e njësisë së shërbimit ligjor, është kryer një analizë e hollësishme financiare e pasurive të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, për periudhën e rivlerësimit 2003 – 2016, bazuar në gjendjet e likuiditeteve, në të ardhurat e ligjshme, shpenzimet, detyrimet financiare, të deklaruara nga subjekti dhe personat e lidhur, duke i krahasuar me informacionet e marra në rrugë zyrtare nga institucionet kompetente ligjore, pasqyruar si në tabelën më poshtë, nga ku në total rezulton me të ardhura të pajustificuara në shumën prej 4.871.306 lekësh. Në këtë analizë, shuma e huas prej 3.000.000 lekësh nga znj. M. B., është marrë në konsideratë si burim i ligjshëm i të ardhurave që kanë shërbyer si burim për investimin në pasurinë shtëpi banimi në fshatin Borsh, Sarandë.

	1	2	3	4	5	6
Përshkrimi	Pasuri	Detyrime	Pasuri neto (1-2)	Të ardhura	Shpenzime	Diferenca (të ardhura -pasuri-shpenzime 4-3-5)
deri 2003	1.079.778	218.110	861.668	3.763.267	3.331.512	-429.913
2004	300.000	-54.085	354.085	766.591	375.856	36.650

³⁶ Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 16.10.2019, nga Njësia Bashkiake Nr. ***, bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr.2, në dosjen e Komisionit.

2005	168.473	-164.024	332.498	793.430	654.907	-193.975
2006	253.093	0	253.093	960.339	505.518	201.729
2007	318.653	0	318.653	1.298.588	730.868	249.067
2008	25.470	0	25.470	1.260.166	611.767	622.930
2009	6.217.485	6.000.000	217.485	1.685.687	684.033	784.169
2010	2.397.543	-548.421	2.945.964	1.878.852	907.619	-1.974.731
2011	-98.978	-2.637.330	2.538.352	2.198.982	824.131	-1.163.501
2012	546.527	-836.871	1.383.398	1.927.926	888.744	-344.216
2013	248.798	-1.577.373	1.826.171	2.076.831	849.666	-599.006
2014	25.122	-400.000	425.122	2.202.051	1.048.124	728.805
2015	1.201.053	0	1.201.053	2.184.093	1.149.004	-165.964
2016	760.523	0	760.523	2.510.626	987.713	762.390
TOTAL	13.443.540	5	13.443.535	25.507.429	13.549.461	
						-4.871.306

Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare

Gjatë kësaj analize, Njësia e Shërbimit Ligjor pranë Komisionit, është bazuar në:

a. Gjendjet e likuiditeteve të subjektit dhe personave të lidhur, të nxjerra nga dokumentet bankare nga “Credins Bank”³⁷, “Raiffeisen Bank”³⁸, BKT³⁹ dhe “Union Bank”⁴⁰, si dhe gjendjet *cash* të deklaruara nga subjekti⁴¹.

b. Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen:

i) të ardhurat nga paga si prokuror⁴²;

ii) të ardhura të bashkëjetueses si: juriste pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave për vitet 2008, 2012 - 2016⁴³; juriste pranë Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, për periudhën 13.8.2008 – 15.10.2012⁴⁴; juriste në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, për periudhën 14.7.2006 – 27.2.2008⁴⁵; pranë BKT-së, për vitet 1996 - 1998⁴⁶; pranë Rezervave Materiale të Shtetit, për vitet 9.3.1995 – 30.9.1996⁴⁷;

iii) të ardhura të djalit pranë shoqërisë “Ansig”.⁴⁸

c. Shpenzimet, ku përfshihen:

³⁷ Shkresa nr. *** prot., datë 11.4.2019, nga “Credins Bank”.

³⁸ Shkresa nr. *** prot., datë 26.2.2019, nga “Raiffeisen Bank”.

³⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 12.3.2019, nga BKT-ja.

⁴⁰ Shkresa nr. *** prot., datë 12.3.2019, nga “Union Bank”.

⁴¹ Shihni deklaratimet periodike të çdo viti, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴² Vërtetim nr. *** prot., datë 25.10.2016, i Prokurorisë së Përgjithshme; vërtetim pa nr., datë 20.1.2017, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; vërtetim nr. *** prot., datë 28.10.2016, nga universiteti “Sevasti e Parashqevi Qiriazi”, njohur pjesën e pagës kaluar në “Union Bank”.

⁴³ Vërtetim nr. *** prot., datë 31.10.2016 dhe vërtetim nr. *** prot., datë 23.1.2017, i Ministrisë së Drejtësisë, Agjencia e Trajtimit të Pronave.

⁴⁴ Vërtetim nr. *** prot., datë 26.10/2016, i Ministrisë së Drejtësisë, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

⁴⁵ Vërtetim nr. *** prot., datë 26.10.2016, i Ministrisë së Drejtësisë, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

⁴⁶ Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore; vërtetim nr. *** prot., datë 26.10.2016, i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit.

⁴⁷ Vërtetim nr. *** prot., datë 26.10.2016, i Ministrisë së Punëve të Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit.

⁴⁸ Vërtetim nga “Ansig”, pa nr. dhe pa datë.

i) shpenzimet e jetesës, bazuar në shpenzimet mujore për konsum sipas madhësisë së NJEH, (anketa e buxhetit të familjes nga INSTAT) për vitet 2000 - 2016 dhe 80 % e të ardhurave për vitet 1994 - 1999;

ii) shpenzime udhëtimi për të cilat janë marrë të dhëna nga sistemi *TIMS*. Për përlogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit janë marrë si bazë shpenzimet mesatare të udhëtimeve sipas linjave ajrore, duke filluar nga 180 euro/udhëtim deri në 300 euro/udhëtim për linjat më të gjata. Në rastet kur ka informacion për destinacionet e largëta, shpenzimet e udhëtimit janë llogaritur duke parë në internet çmimet mesatare të destinacionit përkatës. Ndërsa, për shpenzimet e qëndrimit janë llogaritur 50 euro/ditë shpenzim qëndrimi dhe ushqimi. Në rastet kur është deklaruar qëndrim te familjarët shpenzimet e qëndrimit janë llogaritur 5 euro/ditë. Në rast se shpenzimet e udhëtimit të deklaruara nga subjekti kanë qenë më të larta se ato të llogaritura nga Komisioni, shpenzimet e udhëtimit janë vendosur sa ato të deklaruara;

iii) shpenzime arredimi të deklaruara nga subjekti në pyetësorët e dërguar nga Komisioni;

iv) shpenzime interesa kredie dhe shpenzime të tjera të deklaruara nga subjekti në përgjigje të pyetësorëve të nisur nga Komisioni.

ç. vlerat e kredisë dhe të shlyerjes së saj⁴⁹, huat e marra dhe shlyerjet.⁵⁰

d. vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, bazuar në kontratat e shitblerjeve të këtyre pasurive⁵¹.

III. SEANCA DËGJIMORE

Seanca dëgjimore e subjektit të rivlerësimit, z. Adnand Xhelili, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në datën 31.1.2020, në sallën e konferencave, në Pallatin e Koncerteve, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs.

Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin e tij, duke parashtruar shpjegime dhe opinione lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke kërkuar riçeljen e hetimit për dy kriteret e tjera.

Në datën 12.2.2020 u zhvillua seanca për shpalljen e vendimit për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit bazuar vetëm në kriterin e pasurisë, pasi subjekti nuk paraqiti prova dhe dokumente shkresore për të vërtetuar të kundërtën e barrës së provës në lidhje me rezultatet e hetimit për kriterin e pasurisë, të tilla që do të bënin të domosdoshëm riçeljen e hetimit edhe për dy kriteret e tjera.

IV. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Z. Adnand Xhelili nuk ka qenë plotësisht bashkëpunues në procesin e rivlerësimit ndaj tij, duke iu përgjigjur shkurtimisht pyetjeve të drejtuara nga Komisioni, ndërkohë që në disa raste nuk ka dhënë asnjë përgjigje për disa nga pyetjet e dërguara.

V. KONKUZION PËRFUNDIMTAR

Në përfundim të procesit të rivlerësimit të subjektit Adnand Xhelili vetëm për kriterin e pasurisë, u vërtetua se:

1. Subjekti ka kryer deklarime të pasakta dhe që vijnë në kundërshtim me ligjin në deklaratat periodike vjetore dhe në deklaratën “Vetting”, sipas germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016 dhe të pikave 1 dhe 2, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

⁴⁹ Shkresa nr. ***prot., datë 11.4.2019, nga “Credins Bank”.

⁵⁰ Kontratë nr. ***, datë 8.6.2009, midis M. Xh. dhe M. B..

⁵¹ Shihni kontratat e shitjeve për pasuritë e paluajtshme, në dosjen e ILDKPKI-së.

2. Ka mungesë të ardhurash financiare për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera gjatë periudhës së rivlerësimit, për shkak të një likuiditeti të pajustificuar me të ardhura të ligjshme në shumën totale prej 4.871.306 lekësh, sipas germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, si rrjedhim, nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave dhe pasurive, sipas pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

Në këto rrethana, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pamjaftueshme për kriterin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, të cilat, sipas pikës 3, të nenit 61, të këtij ligji, përbejnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Për rrjedhojë, referuar pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, i dhe standartit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, vendimi për subjektin e rivlerësimit është marrë bazuar vetëm në kriterin e pasurisë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, sipas parashikimit të pikës 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në nenin 61, pika 3, nenin 58, pika 1, germa “c”, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe në pikat 1, 2 dhe 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Adnand Xhelili, me detyrë prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit. Ky vendim u shpall në Tiranë në datën 12.2.2020.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

**Kryesues
Olsi KOMICI**

**Anëtar/relator
Firdes Shuli**

**Anëtar
Brunilda Bekteshi**

*Sekretare gjyqësore
Anisa Duka*